

VENDIM

Nr. 555, datë 11.8.2011

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT MJEKËSOR, TË PUNONJËSVE TË TJERË ME ARSIM TË LARTË DHE TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE, NË SISTEMIN E MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË, NË NJËSINË MJEKËSORE USHTARAKE PRANË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS, NË STRUKTURAT E TJERA TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE DHE SPITALIN PËRKATËS

(ndryshuar me VKM nr. 527, datë 16.8.2012; nr. 1035, datë 27.11.2013; nr. 241, datë 18.3.2015; nr. 527, datë 18.6.2015; nr. 911, datë 21.12.2016; nr. 188, datë 15.3.2017; nr. 555, datë 29.9.2018; nr. 243, datë 19.4.2019, nr. 564, datë 16.7.2020; nr. 1076, datë 24.12.2020; nr. 88, datë 17.2.2021; nr. 286, datë 19.5.2021, nr. 179, datë 30.3.2022; nr. 466, datë 6.7.2022; nr. 711, datë 11.11.2022; nr. 245, datë 20.4.2023¹; nr. 794, datë 28.12.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011” me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

a) personeli mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;

b) personeli teknik i shkencave mjekësore në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;

c) personeli mjekësor, punonjësit e tjerë civilë me arsim të lartë dhe personeli teknik i shkencave mjekësore, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës;

ç) personeli mjekësor ushtarak në strukturat e Forcave të Armatosura, vetëm për efekt të kryerjes së shërbimeve (roje, gatishmëri, urgjencë);

d) personeli mjekësor civil dhe personeli teknik i shkencave mjekësore, civilë, në strukturat e Forcave të Armatosura të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes;

dh) punonjësit e Njesisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes;

e) personeli mjekësor dhe personeli teknik i shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës.

2. Struktura dhe nivelet e pagave për:

a) punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga “specialist” deri në “titullar institucioni”, në strukturat shëndetësore universitare në spitalet e nivelit terciar, në qendrat spitalore rajonale në spitalet rajonale, në spitalet psikiatrike dhe në spitalet bashkiake, janë sipas lidhjes nr. 1 / AP, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) personelin mjekësor në strukturat shëndetësore universitare në spitalet e nivelit terciar dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

¹ Efektet financiare, që rrijedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2023, përballohen nga:

a) fondi për politikat e reja të pagave, fondi i miratuar i kontingjencës, si dhe fondet e akorduara për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për punonjësit e sistemit të kësaj ministrie;

b) fondet e miratuara të kontingjencës, për vitin 2023, për punonjësit e sistemit të Ministrisë së Drejtësisë;

c) fondet e miratuara për vitin 2023 për sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, për punonjësit e sistemit të kësaj ministrie.

c) nëpunësit/punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) personelin mjekësor në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

d) personelin mjekësor në spitalet psikiatrike, rajonale dhe bashkiake, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

dh) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

e) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ë) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Inxhinierisë Biomjekësore, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

f) personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

g) punonjësit me arsim të lartë në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor e Shoqëror janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

gj) punonjësit e Njësisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

h) personelin mjekësor dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës, janë sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

i) personelin mjekësor civil, në strukturat e Forcave të Armatosura të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, janë sipas lidhjes nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

j) personelin teknik të shkencave mjekësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, personelin teknik të shkencave mjekësore, civile, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, janë sipas lidhjes nr. 2 me kërret përkatës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

k) personeli mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës "Shefqet Ndroqi" janë sipas lidhjes nr. 1, kreu 1.11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit me tituj akademikë, që janë të punësuar me kohë të plotë në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP), janë sipas lidhjes nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.2. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e tjerë me arsim të lartë në ISHP, janë sipas lidhjes nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.3. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit laborantë në ISHP, janë sipas lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Paga e grupit (kolona 1 e lidhjes nr. 1 me kërret përkatës, kolona 1 e lidhjes nr. 2 me kërret përkatës, kolona 3 e lidhjes nr. 6, kolona 1 e lidhjes nr. 7, kolona 1 e lidhjes nr. 8 dhe kolona 1 e lidhjes nr. 9), përcaktohet sipas lidhjeve përkatëse të këtij vendimi dhe vlera e saj është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3.1. Shfuqizuar.

4. Shtesa për vjetërsi në punë, kolona 2, e lidhjeve përkatëse, jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4.1 Punonjësit e personelit me tituj akademikë të punësuar me kohë të plotë në ISHP, të cilët trajtohen në pagë sipas lidhjes nr. 5, përfitojnë shtesë për vjetërsi në punë, në masën 0,5 % për çdo vit pune, por jo më shumë se 15 vjet.

5. Shtesa për kualifikim, kolona 3 e lidhjeve përkatëse është 0.

6. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1 dhe të lidhjes nr.2 si dhe të

lidhjes nr. 6, lidhjes nr. 7, lidhjes nr. 8 dhe lidhjes nr. 9.

7. Shtesa për kushte pune është sipas kolonës 5 të lidhjes nr.1 dhe të lidhjes nr.2 si dhe të lidhjes nr.7, lidhjes nr. 5, lidhjes nr. 6 dhe lidhjes nr. 8.

8. *Shfuqizuar.*

9. Mjekët dhe punonjësit e infermieristikës, që punojnë larg vendbanimit, marrin shpërblim mujor në masën si më poshtë vijon:

9/1 Për mjekët:

a) kur punojnë në rrethet: Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë, 4500 lekë në muaj;

b) kur punojnë në rrethet: Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd, 3 800 lekë në muaj.

9/2 Për punonjësit e personelit teknik të shkencave mjekësore:

a) kur punojnë brenda rrethit të tyre, por larg vendbanimit dhe kthehen brenda ditës, 3 000 lekë në muaj.

b) kur nuk kthehen në vendbanim brenda ditës, 4 000 lekë në muaj.

10. Për punonjësit e personelit mjekësor që nuk janë efektivë me kohë të plotë në qendrat spitalore e shëndetësore të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë e të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, për shërbimin që kryejnë në këto qendra, kontrahohen me orë pune të caktuara. Vlera e pagesës së një ore pune të kontraktuar është e njëjtë me vlerën orare të pozicionit të punës, për të cilin është kontraktuar.

10/1. *Trajtimi financiar i punonjësve mjekësorë të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, që shërbejnë në institucionet shëndetësore, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave është, si vijon:*

	Kualifikimi/grada/titulli shkencor	Trajtimi financiar (lekë/muaj)
1	Shef shërbimi me titullin "Profesor".	125 000
2	Shef shërbimi me titullin "Profesor i asociuar".	120 000
3	Shef shërbimi me gradën "Doktor i shkencave".	117 000

10/2. *Trajtimi financiar i punonjësve mjekësorë të korpusit akademik të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, që shërbejnë pranë Institutit të Shëndetit Publik dhe Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjaktit, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave, është 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë në muaj.*

11. Mjekët e sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe mjekët civilë të strukturave të Forcave të Armatosura, të cilët kryejnë specializimin në qendrat spitalore universitare, gjatë kohës së specializimit, të paguhet në masën 80 për qind të pagës së mjekut të fushës në të cilën kryhet specializimi.

11/1. *Mjekët e sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, të cilët, pas përfundimit të specializimit në spitalet universitare, në bazë të detyrimit kontraktor me ministrinë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë, emërohen sipas nevojave të sistemit shëndetësor, larg vendbanimit të tyre, për një periudhë trevjeçare, përfitojnë një kompensim për kosto jetese, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, sipas specifikimeve që miratohen me udhëzimin të ministrit përgjegjës për çështjet e shëndetësisë, bazuar në shtrirjen territoriale të shërbimit spitalor.*

12. Për kryerjen e shërbimit të rojës, të gatishmërisë dhe urgjencës, të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe mjekëve, civilë e ushtarakë, të strukturave të Forcave të Armatosura u jepet shpërblim si më poshtë vijon:

12/1 Për mjekët:

a) Për çdo shërbim rojë 24 orë pa ndërprerje u jepet një shpërblim:

Në qendrat spitalore universitare:	Mjek rojë i parë	Mjek rojë i dytë
Për ditët e zakonshme	6 000 lekë	5 600 lekë
Për ditët e shtuna	7 000 lekë	6 400 lekë

Për ditët e diela e festat	8 000 lekë	7 600 lekë
----------------------------	------------	------------

Në institucionet e tjera:	Mjek rojë i parë	Mjek rojë i dytë
Për ditët e zakonshme	5 600 lekë	5 200 lekë
Për ditët e shtuna	6 000 lekë	5 600 lekë
Për ditët e diela e festat	7 000 lekë	6 600 lekë

b) Për shërbimin e urgjencës së rrethit, që është organizuar dhe funksionon si i tillë, për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës u jepet një shpërblim në masën:

	Në ditët e zakonshme	Të shtuna	Të diela dhe festa
- për sistemin 24 orë	2 300 lekë	2 400 lekë	2 700 lekë
- për sistemin 16 orë	2 000 lekë	2 300 lekë	2 400 lekë
- për sistemin 12 orë	1 800 lekë	2 000 lekë	2 300 lekë

c) Kur thirren për raste urgjence, pasdite ose natën, nga mjeku i rojës së spitalit, për veprime diagnostikuese apo mjekuese, shpërblehen në masën 600 lekë deri në 1 000 lekë, në varësi të procedurës mjekësore që kryejnë. Këto shpërblime nuk mund të jenë më shumë se 20 për qind e pagës mujore për çdo muaj.

12/2 Për punonjësit e infermieristikës:

a) Për punën e kryer nga ora 19:00 deri në orën 22:00, si dhe për punën e kryer nga ora 22:00 deri në orën 06:00 përfutojnë shtesë mbi pagë, si vijon:

<i>Në spitale dhe në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët</i>	<i>Nga ora 19:00 deri në orën 22:00</i>	<i>Nga ora 22:00 deri në orën 06:00</i>
<i>Për ditët e zakonshme</i>	<i>120 lekë</i>	<i>500 lekë</i>
<i>Për ditët e shtuna</i>	<i>200 lekë</i>	<i>800 lekë</i>
<i>Për ditët e diela e festat</i>	<i>240 lekë</i>	<i>1 000 lekë</i>

b) Për shërbimin e urgjencës së rrethit, që është organizuar dhe funksionon si i tillë, për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës, u jepet një shtesë, si më poshtë vijon:

Në ditët të zakonshme të shtuna të diela dhe festa:

- për sistemin 24 orë 1700 lekë 2100 lekë 2500 lekë;
- për sistemin 16 orë 1400 lekë 1700 lekë 2200 lekë;
- për sistemin 12 orë 1100 lekë 1400 lekë 1700 lekë.

c) Për rastet kur, me kërkesë të institucionit dhe miratim të Ministrisë së Shëndetësisë e Ministrisë së Mbrojtjes, laborantet e spitaleve kryejnë shërbim 24 orë, u jepet një shtesë, si më poshtë vijon:

- për ditë të zakonshme 1 300 lekë
- për ditët e shtuna 1 600 lekë
- për ditët e diela dhe festa 2 100 lekë

ç) Për raste të veçanta, kur mjeku i rojës e shih të domosdoshme thirrjen e personelit të infermieristikës për kryerjen e ekzaminimit apo të mjekimit, ky personel shpërblehet në masën 300 lekë deri në 750 lekë, për çdo rast. Këto shpërblime nuk mund të jenë më shumë se 20% e pagës mujore për çdo muaj.

12/3 Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Mbrojtjes përcaktojnë kriteret dhe rregullat për dhënien e shpërblimit, sipas pikave 12/1 dhe 12/2 të këtij vendimi.

12/4. Shpërblimi i punonjësve të personelit të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi, pjesë e Institutit të Shëndetit Publik, është në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

12/5. Mjekët e spítaleve në shërbimin e urgjencës, shërbimin e reanimacionit, shërbimin e hemodinamikës, në njësinë e aksidenteve cerebrale, si dhe mjekët neonatë, përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

12/6. Infermierët dhe laborantët e spítaleve në shërbimin e urgjencës, shërbimin e reanimacionit, shërbimin e hemodinamikës dhe në njësinë e aksidenteve cerebrale përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

12/7. Mjekët, të cilët në zbatim të sistemit të referimit dërgohen për konsulta dhe ndërhyrje kirurgjikale në spítale të tjera, përfitojnë për çdo ditë shërbimi një shtesë në page, si më poshtë vijon:

- a) mjekët e institucioneve spítalore universitare 10 000 lekë;
- b) mjekët e spítaleve rajonale 5 000 lekë.

13. Mjekët me tituj e grada shkencore, të cilët janë punonjës efektivë të qendrave spítalore e shërbimeve universitare, si dhe të klinikës stomatologjike, që gëzojnë statusin e qendrave kërkimore-shkencore si dhe në spítalin rajonal "Memorial" Fier, trajtohen në pagë sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

14. Për çdo fluturim, pilotët dhe teknikët e Njësisë së Transportit Mjekësor me Helikopterë paguhen në masën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë.

14/1. "Specialistët", "përgjegjësit e sektorit" apo "drejtorët e drejtorive" të institucioneve të kujdesit shëndetësor të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të shërbimit shëndetësor dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit "Master i shkencave/Master profesional/Bachelor" apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët "Inxhinieri elektronike", "Inxhinieri informatike", "Informatikë", "Inxhinieri telekomunikacioni", "Teknologji informacioni", "Informatikë ekonomike", "Inxhinieri matematike informatike" apo "Shkenca kompjuterike", në masën:

- 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK-ut, të institucioneve qendrore të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në qendrat spítalore universitare/spítalin rajonal "Memorial" Fier;

- 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK-ut, të spítaleve rajonale apo bashkiake, të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Zbatimi i shtesave si më sipër për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike, sipas përsëkrimit të pozicionit të punës.

Përyjashtohen nga ky parashikim nëpunësit e strukturave të TIK-ut, të institucioneve të kujdesit shëndetësor të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që janë bërë pjesë e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

15. Shfuqizuar.

15/1. Shfuqizuar.

16. Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve që bëjnë pjesë në fushën e veprimit të këtij vendimi, përcaktohen në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore".

17. Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

17.1. Funkionarët dhe nëpunësit, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi, nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë, të përcaktuara me vendime të tjera të Këshillit të Ministrave.

18. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2011.

19. Trajnimi i personelit mjekësor, personelit paramedikal dhe publikut të gjerë kryhet nëpërmjet veprimtarive të trajnimit që organizohen nga vetë Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore ose/dhe në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë apo qendrat spítalore.

Në rastet kur punonjësit e personelit mjekësor (me arsim të lartë) të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore marrin pjesë në veprimtaritë e trajnimit (si për personelin mjekësor ashtu edhe për personelin paramedikal dhe publikun e gjerë), të cilat organizohen nga vetë qendra, për çdo orë mësimi 60-minutësh përfitojnë trajtim me pagesë, si më poshtë vijon:

- a) Trajnerët me më pak se 10 (dhjetë) vite punë në profesion përfitojnë një pagesë 750 (shtatëqind e pesëdhjetë)

lekë për orë;

b) Trajnerët me më shumë se 10 vite punë në profesion përfitojnë një pagesë 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë për orë.

Trajnerët të cilët janë punonjës të personelit mjekësor (me arsim të lartë) të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore e përfitojnë këtë pagesë deri në 200 (dyqind) orë në vit.

Në rastet kur trajnerët janë bashkëpunëtorë të jashtëm nga Universiteti i Mjekësisë apo nga qendrat spitalore, pagesa për orë do të jetë e njëjtë me trajnerët e brendshëm të qendrës.

20. Për një periudhë tranzitore (3-vjeçare) të funksionimit të spitalit rajonal "Memorial" në Fier, në bashkëpunim me personat e caktuar nga Ministria e Shëndetësisë Turke, pagat e punonjësve turq, të personelit të administrimit të përgjithshëm, të personelit mjekësor dhe të personelit teknik të shkencave mjekësore, të jenë të njëjta me pagat e çdo pozicioni respektiv pune, sipas lidhjes nr. 1/AP, lidhjes nr. 1 (kreu 1.1) dhe lidhjes nr. 2 (kreu 2.1) të këtij vendimi.

Përveç pagës, sipas lidhjeve përkatëse si më sipër, punonjësit turq të personelit të administrimit të përgjithshëm, të personelit mjekësor dhe të personelit teknik të shkencave mjekësore do të përfitojnë edhe një shpërblim mujor, në masën e përcaktuar në lidhjen nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

21. Për një periudhë transitore 2-vjeçare të punës për autonominë spitalore të spitaleve publike, në bashkëpunim me personat e caktuar nga Ministria e Shëndetësisë Turke, pagat e punonjësve turq në pozicionin "Menaxher spitalor" janë të njëjta me pozicionet respektive të punës sipas lidhjes nr. 1/AP.

Përveç pagës sipas lidhjes nr. 1/AP, punonjësit turq në pozicionet "Menaxher spitalor", përfitojnë edhe një shpërblim mujor, në masën e përcaktuar në lidhjen nr. 10.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1 (lidhja 1/AP)

(shtuar fjalë në titull me VKM nr. 794, datë 28.12.2023)

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga "specialist" deri në "titullar institucioni" në struktura shëndetësore universitare, në spitalet e nivelit terciar, në qendrat spitalore rajonale, në spitalet rajonale, spitalet psikiatrike dhe spitalet bashkiake

(Ndryshuar me VKM nr. 1076, datë 24.12.2020; ndryshuar me VKM nr. 286, datë

19.5.2021, ndryshuar lidhja 1/AP dhe kërret 1.1 deri 1.8, të lidhjes nr. 1 me vendimin nr. 466, datë 6.7.2022; shtuar emërtesa në nënndarjen 4 me VKM nr. 711, datë 11.11.2022; nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		<i>Paga e grupit (PG)</i>	<i>Shtesa për vjetërsi (SHV)</i>	<i>Shtesa për kualifikim (SHK)</i>	<i>Shtesa për pozicion (SHIP)</i>	<i>Shtesa për kushte pune (SHKP)</i>
		1	2	3	4	5
1	Titullar institucioni në QSU “Nënë Tereza”. Titullar institucioni në spitalin rajonal “Memorial” Fier.	1	2%		146 000	25 000
2	Titullar institucioni në: Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”. Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik nr. 1 dhe nr. 2 Tiranë. Spitalin Universitar të Traumës Tiranë.	1	2%		146 000	15 000
3	Titullar institucioni në: Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë. Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Zëvendëstitullar institucioni në QSU “Nënë Tereza”. Zëvendëstitullar institucioni në spitalin rajonal “Memorial” Fier.	1	2%		139 000	15 000
4	Titullar institucioni në spitalet rajonale. Titullar institucioni në spitalet psikiatrike. Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale (profili mjekësor /ekonomik). Konsulent mjekësor në spitalet universitare dhe terciare.	1	2%		126 000	12 000
5	Zëvendëstitullar institucioni në: Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”. Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik nr. 1, nr. 2 Tiranë. Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë. Spitalin Universitar të Traumës Tiranë. Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	2%		126 000	
6	Titullar institucioni në spitalet bashkiake.	1	2%		121 000	
7	Zëvendëstitullar institucioni në spitalet rajonale/psikiatrike/ bashkiake.	1	2%		102 000	
8	Drejtor drejtorie në QSU “Nënë Tereza”. Drejtor drejtorie në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier.	1	2%		105 000	
9	Drejtor drejtorie në: Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”. Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik nr. 1, nr. 2 Tiranë. Spitalin Universitar të Traumës Tiranë. Përgjegjës sektori biomedikal. Administrator për Polin e administrimit të integruar në QSU “Nënë Tereza”.	1	2%		95 000	
10	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbytjes në spitalet universitare në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Përgjegjës sektori në sektorët e përmbytjes në	1	2%		90 000	

	spitalin rajonal "Memorial" Fier.					
11	Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës në spitalet universitare, në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës "Shefqet Ndroqi" dhe në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Përgjegjës sektori në Klinikën Stomatologjike Universitare. Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës në Spitalin Rajonal "Memorial" Fier.	1	2%		80 000	
12	Përgjegjës sektori në spitalet rajonale dhe psikiatrike.	1	2%		70 000	
13	Specialist në sektorin biomedikal (inxhinier/ IT/biomedikal) në spitalet universitare, në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës "Shefqet Ndroqi", në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe në Spitalin Rajonal "Memorial" Fier.	1	2%		75 000	5 000
14	Përgjegjës sektori në spitalet bashkiake.	1	2%		60 000	
15	Specialist në sektorin biomedikal (inxhinier/ IT/biomedikal) në spitalet rajonale, psikiatrike dhe bashkiake.	1	2%		60 000	5 000
16	Specialist auditi/specialist në QSU "Nënë Tereza" dhe në Spitalin Rajonal "Memorial" Fier.	1 ose 2, ose 3	2%		75 000	
17	Specialist në spitalet universitare, në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës "Shefqet Ndroqi"/Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë/Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1 ose 2, ose 3	2%		70 000	
18	Specialist në spitalet rajonale dhe psikiatrike.	1 ose 2, ose 3	2%		60 000	
19	Specialist në spitalet bashkiake.	1 ose 2, ose 3	2%		50 000	

Lidhja nr. 1 (kreu I.1)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në strukturat shëndetësore universitare, në spitalet e nivelit terciar dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës

(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023; ndryshuar emërtesa dhe shtuar pozicione me Vkm nr. 794, datë 28.12.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtues mjekësor në QSU "Nënë Tereza"/shef shërbimi.	1	2%		159 800	
2	Shef shërbimi infektiv në QSU "Nënë Tereza" dhe Spitalin rajonal "Memorial" Fier.	1	2%		159 800	8 000
3	Përgjegjës njësie/klinike. (mjek me specialitet).	1	2%		145 700	

4	Përgjegjës njësie/klinike në Shërbimin Infektiv në QSU “Nënë Tereza” (mjek me specialitet).	1	2%		145 700	8 000
5	Përgjegjës njësie/klinike në Psikiatri/Radioterapi/Mjekësi nukleare. (mjek me specialitet).	1	2%		145 700	5 000
6	Përgjegjës njësie/klinike në Reanimacion /Kimioterapi. Përgjegjës laborator. Përgjegjës i Qendrës së Diagnozës Molekulare (mjek me specialitet).	1	2%		145 700	3 700
7	Përgjegjës mjekësor në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (mjek me specialitet).	1	2%		137 400	3 000
8	Shef/Përgjegjës farmacie.	1	2%		93 500	5 000
9	Mjekë me specialitet në shërbimet Kirurgji/ Onkologji/ Obstetrikë-Gjinekologji/ Fizioterapi/ Pneumofiziatri/ Toksikologji/Kimioterapi/ Laborator/ Hematologji.	1	2%		134 600	2 000
10	Mjekë me specialitet në shërbimet e Reanimacionit/ Mjekësi nukleare/Radiologji/ Radioterapi/ Neonatologji/ Hemodinamikë/ DSA/Urgjencë.	1	2%		134 600	3 700
11	Mjek me specialitet në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	2%		134 600	1 600
12	Mjekë me specialitet në shërbimet spitalore. Mjek me specialitet në Klinikën Stomatologjike Universitare.	1	2%		134 600	
13	Mjek me specialitet në shërbimin infektiv në QSU “Nënë Tereza”. Mjek infeksionist në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier.	1	2%		134 600	8 000
14	Mjek me specialitet në shërbimet psikiatrike.	1	2%		134 600	5 000
15	Psikolog/punonjës Social në shërbimet psikiatrike.	1	2%		90 600	5 000
16	Mjek i përgjithshëm/ stomatolog/kimist/fizikan/ biolog në shërbimet klinike.	1	2%		90 600	
17	Kimist/biolog në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	2%		90 600	1 600
18	Psikolog/punonjës social/ specialist i shëndetit publik/specialist fizikulture.	1	2%		90 600	
19.	Fizikan në Radioterapi/Radiokirurgji/Mjekësi nukleare	1	2%		90 600	3 700
20.	Mjek i përgjithshëm në urgjencë/Farmacist	1	2%		90 600	2 500

Lidhja nr. 1 (kreu 1.2)

Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit/punonjësit e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor

(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023; shtuar pozicione në pjesën e II me Vkm nr. 794, datë 28.12.2023)

I. Në drejtorinë qendrore dhe në drejtoritë rajonale

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		<i>Paga e grupit (PG)</i>	<i>Shtesa për vjetërsi (SHV)</i>	<i>Shtesa për kualifikim (SHK)</i>	<i>Shtesa për pozicion (SHP)</i>	<i>Shtesa për kushte pune (SHKP)</i>
		1	2	3	4	5
1	Drejtor i përgjithshëm.	1	2%		140 000	
2	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm.	1	2%		130 000	
3	Drejtor drejtorie në drejtorinë qendrore.	1	2%		121 000	
4	Drejtor i drejtorisë rajonale.	1	2%		128 000	
5	Përgjegjës sektori në drejtorinë qendrore. Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale.	1	2%		95 000	
6	Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale.	1	2%		80 000	
7	Specialist (niveli i parë).	1 ose 2 ose 3	2%		70 000	
8	Specialist (niveli i dytë).	1 ose 2 ose 3	2%		60 000	

II. Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		<i>Paga e grupit (PG)</i>	<i>Shtesa për vjetërsi (SHV)</i>	<i>Shtesa për kualifikim (SHK)</i>	<i>Shtesa për pozicion (SHP)</i>	<i>Shtesa për kushte pune (SHKP)</i>
		1	2	3	4	5
1	Titullar i njësite vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në qarqe.	1	2%		126 000	
2	Titullar i njësite vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në bashki.	1	2%		121 000	
3	Shef shërbimi.	1	2%		105 500	
4	Përgjegjës sektori	1	2%		72 000	
5	Përgjegjës në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër dhe shërbimet komunitare (mjek psikiatër).	1	2%		127 000	5 000
6	Mjek/specialist në shërbimet e shëndetit publik.	1	2%		73 100	7 000
7	Mjek/stomatolog/farmacit/inxhinier/specialist në sektorin e shërbimit parësor.	1	2%		73 100	
8	Psikolog/punonjës social që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor.	1	2%		73 100	5 000
9	Mjek psikiatër që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër dhe shërbimet komunitare.	1	2%		118 200	5 000
10	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%		60 000	
11	Kryeinfermier/kryevaksinotor.	1	2%		60 400	
12	Teknik specialitetesh shëndetësore.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	2%		53 300	1 100
13	Infermier/terapist në shërbimet e shëndetit mendor.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	2%		53 300	5 000
14	Infermier.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	2%		53 300	
15	Shef shërbimi (mjek mikrobiolog) që punon në shërbimet e shëndetit publik.	1	2%		127 000	
16	Përgjegjës/shef në shërbimet e shëndetit	1	2%		82 600	5 000

	mendor me shtretër dhe shërbimet komunitare (punonjës social/psikolog).					
17.	Mjek mikrobiolog që punon në shërbimet e shëndetit publik.	1	2%		118 200	7 000

Lidhja nr. 1 (kreu 1.3)

**Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në Qendrën Kombëtare
Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët**
(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor i përgjithshëm.	1	2%		139 000	8 000
2	Zëvendës drejtor i përgjithshëm.	1	2%		119 000	8 000
3	Shef shërbimi (mjek me specialitet).	1	2%		136 900	5 000
4	Përgjegjës sektori.	1	2%		80 000	2 000
5	Mjek me specialitet.	1	2%		121 000	5 000
6	Mjek në shërbimin klinik.	1	2%		76 000	5 000
7	Specialist psikolog, punonjës social/terapist/fizioterapist/logopedist/pedagogj i e specializuar.	1 ose 2 ose 3	2%		73 100	5 000
8	Specialist promocioni.	1 ose 2 ose 3	2%		70 000	2 000
9	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%		60 000	2 000

Lidhja nr. 1 (kreu 1.4)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor në spitalet psikiatrike, rajonale dhe bashkiake
(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Shef shërbimi (mjek me specialitet).	1	2%	0	136 900	
2	Shef shërbimi Psikiatri. (mjek me specialitet).	1	2%	0	136 900	5 000
3	Shef shërbimi në Infektiv (mjek me specialitet).	1	2%	0	136 900	2 500
4	Përgjegjës njësie/Klinike/ Kabineti/Poliklinike. (mjek me specialitet).	1	2%		124 000	
5	Përgjegjës njësie/klinike psikiatrie (mjek me specialitet).	1	2%	0	124 000	5 000
6	Përgjegjës i Bankës së Gjakut/ Njësisë së Imazherisë/ Pneumoftiziatri/Laboratori. (mjekë me specialitete).	1	2%	0	124 000	2 500

7	Shef/përgjegjës njësie/klinike (mjek i përgjithshëm).	1	2%	0	79 200	
8	Përgjegjës/Shef farmacie.	1	2%	0	93 000	
9	Mjek me specialitet në spitalet rajonale/ bashkiake.	1	2%	0	118 300	
10	Mjekë me specialitet në shërbimet Kirurgji/ Infektiv/Onkologji/ Obsetrikë-Gjinekologji/ Fizioterapi/Transfuziolog/ Pneumofiziatri/ Toksikologji/Kemioterapi/Laborator/ Hematologji.	1	2%	0	118 300	2 000
11	Mjekë me specialitet në shërbimet e Reanimacionit/ Radiologji/ Neonatologji/ Hemodinamikë/Urgjencë.	1	2%	0	118 300	3 700
12	Mjek psikiatër/mjek specialist në spitalet psikiatrike.	1	2%	0	118 300	5 000
13	Mjek i përgjithshëm/ stomatolog / farmacist. Psikolog, punonjës social në spitalet psikiatrike.	1	2%	0	73 100	5 000
14	Mjek i përgjithshëm/ stomatolog/farmacist. Kimist/fizikan/biolog.	1	2%	0	73 100	2 500
15	Psikolog, punonjës socialë në spitalet rajonale dhe bashkiake.	1	2%	0	73 100	

Lidhja nr. 1 (kreu 1.5)

Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor.	1	2%		121 000	7 000
2	Zëvendësdrejtor.	1	2%		119 000	7 000
3	Përgjegjës/Shef sektori në sektorët për kontrollin e barnave.	1	2%		93 000	
4	Përgjegjës/Shef sektori në sektorët e tjerë.	1	2%		80 000	
5	Farmacist. Analist. Mjek. Inxhinier për pajisjet mjekësore.	1	2%		85 100	4 000
6	Farmacist. Inspektor për Kontrollin Farmaceutik.	1	2%		85 100	5 000
7	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%		60 000	

Lidhja nr. 1 (kreu 1.6)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore

(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023; ndryshuar vlera e elementit "Shtesë për pozicion" me Vkm nr. 794, datë 28.12.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor.	1	2%		128 000	

2	Përgjegjës/Shef sektori.	1	2%		70 000	
3	Mjek me specialitet.	1	2%		118 300	
4	Mjek të përgjithshëm. Stomatolog.	1	2%		73 100	
5	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%		60 000	

Lidhja nr. 1 (kreu 1.7)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Qendrën e Inxhinierisë Biomjekësore
(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor i përgjithshëm.	1	2%		126 000	5 000
2	Zëvendësrejtore i përgjithshëm.	1	2%		119 000	
3	Drejtor drejtorie.	1	2%		105 000	
4	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes.	1	2%		90 000	5 000
5	Përgjegjës sektori.	1	2%		70 000	
6	Specialist (inxhinier /IT/biomedikal).	1	2%		80 000	5 000
7	Specialist.	1 ose 2 ose 3	2%		60 000	

Lidhja nr. 1 (kreu 1.8)

Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore
(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Drejtor i përgjithshëm.	1	2%		146 000	
2	Zëvendësrejtore i përgjithshëm.	1	2%		126 000	
3	Drejtor i Koordinimit të Urgjencës Mjekësore.	1	2%		121 000	
4	Drejtor drejtorie.	1	2%		105 000	
5	Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit të Urgjencës Mjekësore.	1	2%		95 000	
6	Përgjegjës sektori.	1	2%		80 000	
7	Specialist (mjek).	1	2%		90 500	2 000
8	Specialist.	1 ose 2, ose 3	2%		65 000	

Lidhja nr. 1 (kreu 1.9)

Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor e Shoqëror
(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 179, datë 30.3.2022; nr. 245, datë 20.4.2023)

EMËRTIMI		PAGA MUJORE				
		<i>Paga e grupit (PG)</i>	<i>Shtesa për vjetërsi (SHV)</i>	<i>Shtesa për kualifikim (SHK)</i>	<i>Shtesa për pozicion (SHP)</i>	<i>Shtesa për kushte pune (SHKP)</i>
		1	2	3	4	5
1	Drejtor i përgjithshëm.	1	2%		121 000	
2	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm. Drejtor drejtorie.	1	2%		102 000	
3	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes.	1	2%		90 000	
4	Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës.	1	2%		80 000	
5	Specialist në sektorët e përmbajtjes.	1 ose 2	2%		70 000	
6	Specialist në sektorët mbështetës.	1 ose 2 ose 3	2%		60 000	

Lidhja 1 (Kreu 1.10)

Struktura e pagave për punonjësit në Njësinë e Helikopterëve të Transportit Mjekësor të Shëndetësisë në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes
(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

EMËRTIMI		PAGA MUJORE				
		<i>Paga e grupit (PG)</i>	<i>Shtesa për vjetërsi (SHV)</i>	<i>Shtesa për kualifikim (SHK)</i>	<i>Shtesa për pozicion (SHP)</i>	<i>Shtesa për kushte pune (SHKP)</i>
		1	2	3	4	5
1	Kryepilot	1	2%		94 100	8000
2	Pilot	1	2%		89 800	8000
3	Teknik kelikopteri fluturues	1	2%		86 000	

Lidhja nr. 1 (kreu 1.11)

(Shtuar me Vkm nr. 794, datë 28.12.2023)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë, në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”

EMËRTIMI		PAGA MUJORE				
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2		3	4
1	Shef shërbimi në shërbimin universitar/terciar	1	2%		159 800	
2	Përgjegjës njësie/klinike/kabineti (mjek me specialitet) në shërbimin universitar/terciar	1	2%		145 700	
3	Përgjegjës njësie/klinike në Reanimacion	1	2%		145 700	3 700
4	Shef shërbimi në shërbimet e tjera(mjek me specialitet)	1	2%		136 900	
5	Mjekë me specialitet në shërbimet: Reanimacion/Radiologji/Hemodinamikë/Urgjencë	1	2%		134 600	3 700
6	Mjekë me specialitet në shërbimet Kirurgji/ Pneumologji/Laborator/Hematologji	1	2%		134 600	2 000
7	Mjek me specialitet në shërbimin universitar/terciar	1	2%		134 600	
8	Përgjegjës njësie/klinike/kabineti në	1	2%		124 000	

	shërbimet e tjera					
9	Mjekë me specialitet në shërbimet: Pediatri/Neonatologji	1	2%		118 300	3 700
10	Mjekë me specialitet në shërbimet: Obstetrikë-Gjinekologji/Laborator klinik biokimik	1	2%		118 300	2 000
11	Mjekë me specialitet në shërbimet e tjera	1	2%		118 300	
12	Shef/Përgjegjës farmacie	1	2%		93 500	5 000
13	Mjek i përgjithshëm në urgjencën paraspitalore Farmacist	1	2%		90 600	2500
14	Psikolog/Punonjës Social/Specialist i shëndetit publik. Fizikan/Biolog në shërbimin universitar/terciar	1	2%		90 600	
15	Shef/Përgjegjës njësie/Klinike (mjek i përgjithshëm)	1	2%		79 200	
16	Psikolog/Punonjës social në shërbimet e tjera	1	2%		73 100	

Lidhja nr. 2 (kreu 2.1)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në strukturat shëndetësore universitare e në spitalet e nivelit terciar dhe personelin teknik të shkencave mjekësore, civilë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës

(ndryshuar lidhja nr. 2, kërret 2.1 deri 2.6 me vendimin nr. 466, datë 6.7.2022; nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermier/Kryemami i Përgjithshëm. Kryeinfermier shërbimi/njësie/klinike në Shërbimin Infektiv në QSU “Nënë Tereza” dhe në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier.		2%		63 600	8 000
2	Kryeinfermier Shërbimi Psikiatrik.		2%		63 600	6 000
3	Kryeinfermier Klinike/Njësi Psikiatrike.		2%		63 600	5 000
4	Kryeinfermier Shërbimi në Terapi Intensive/Onkologjik/ Neurokirurgji. Kryelaborant në Histopatologji/Anatomi Patologjike. Kryeinfermier/Kryelaborant në Radioterapi/Imazheri dhe Mjekësi Nukleare. Kryeinfermier/Kryemami njësie/klinike i Terapisë Intensive/ Strokë dhe Post strokë. Kryeinfermier në Hemodinamikë/ Kemioterapi.		2%		63 600	3 400
5	Kryelaborant klinik biokimik. Kryeinfermier në Urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme/ Hematologji/ Onkohematologji pediatrike/ Hemodializë/ Toksikologji. Kryeinfermier/Kryemami salle. Infermier në Hemodinamikë.		2%		63 600	1 800

	Kryelaborant Imunolog/ Bakteriolog. Kryeinfermier shërbimi në Kirurgji/ Neurologji/Djegje plastike/ Kardiokirurgji/Maksilofacial/Pediatri infektive/Obsetrik. Kryeinfermier/kryemami në njësinë/ klinikën e Kirurgjisë/ Sallë operacioni. Kryemami turni në Kirurgji/ Obsetrikë. Kryeinfermier njësie/klinike në Fizioterapi/ Urologji/Urgjencën e neurologjisë. Neurokirurgji/Onkologji.					
6	Kryeinfermier shërbimi/ Kryelaborant shërbimi/ Kryemami shërbimi. Kryeinfermier/kryelaborant në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.		2%		63 600	
7	Infermier/laborant në Psikiatri		2%		60 400	5 000
8	Laborant histopatolog. Infermier/Mami në Reanimacion/Neonatologji. Infermier në dhomën e zgjimit.		2%		60 400	3 400
9	Infermier në Kimioterapi. Kryelaborant imazherie.		2%		60 600	1 800
10	Laborant radiolog në Onkologji. Laborant në Radioterapi. Laborant në Mjekësinë Nukleare.		2%		53 300	3 700
11	Kryeinfermier njësie/klinike pranim urgjence. Laborant klinik biokimik. Infermier në Puntin e gjakut/ Hematologji/ Hemodializë/ Onkologji/Endoskopi/Toksikologji. Infermier/Laborant bakteriolog /imunolog. Infermier njësie/klinike Radiologji/Angio CT. Teknik Imazherie dhe Angio CT. Laborant radiolog. Laborant në Neurofiziologji. Kryeinfermier në Pranim Urgjence /Djegje plastike/Kirurgji. Kryemami në Qendrën e Gruas. Infermier në Kirurgji/Maksilofaciale/ Neurokirurgji/Kardiokirurgji/Djegje plastike. Infermier/mami në Obsetrike/ Gjinekologji/ Patologji barre/ Neonatologji. Infermier salle. Infermier/laborant në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.		2%		53 300	1 800
12	Kryeinfermier/kryemami /kryelaborant		2%		53 300	
13	Infermier në njësinë e radioterapisë dhe mjekësisë nukleare. Infermier në litotripsi.		2%		51 100	3 300
14	Infermier në Shërbimin Infektiv në QSU “Nënë Tereza” dhe në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier.		2%		51 100	8 000
15	Infermier Pranim Urgjence (njësia e koordinimit të urgjencës).		2%		51 100	1 800

	Infermier në Hemodializë. Infermier fizioterapi.					
16	Laborant/infermier/mami/ logopedi. Kujdestar/prozektor.		2%		51 100	
17	Kujdestar në Psikiatri.		2%		45 000	5 000

Lidhja nr. 2 (kreu 2.2)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët
(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE E RE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermier		2%		60 400	5 000
2	Infermier		2%		51 100	5 000
3	Kujdestar		2%		45 000	5 000

Lidhja nr. 2 (kreu 2.3)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në spitalet psikiatrike, rajonale e bashkiake dhe personelin teknik të shkencave mjekësore, civilë, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes
(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermier i përgjithshëm.		2%		63 600	1 500
2	Kryeinfermier i përgjithshëm në spitalet psikiatrike.		2%		63 600	6 000
3	Kryeinfermier Njësie/klinike në spitale psikiatrike.		2%		63 600	5 000
4	Kryeinfermier.		2%		60 400	
5	Kryelaborant në Laboratorin Klinik Biokimik, Bakteriologjik. Kryeinfermier në Kirurgji/ Reanimacion/Sallë operacioni/ Obsetrikë/Gjinekologji.		2%		60 400	1 500
6	Laborant në Anatominë Patologjike.		2%		60 400	3 400
7	Infermier/laborant në Psikiatri		2%		53 300	5 000
8	Kryeinfermier në poliklinikën e spitalit. Infermier në Reanimacion /Imazheri/ në Sallë/ Hemodializë/ Fizioterapi /Ergoterapi/Logoterapi/Neuropsikiatri/ Infektiv/Dispanseri të Sëmundjeve Ngjitëse /Kirurgji/ Ortopedi/ Obsetrikë / Gjinekologji /Pneumoftziatri/ Onkologji		2%		51 100	1 500

	/Dispanceri. Infermier në njësinë/klinikën e lindjes. Infermier/Laborant në bankën e gjakut / Hematologji. Përgjegjës turni. Ndhmësanestezist/ndihmësfarmacist. Laborant Radiologjie. Kryeinfermier në Qendrën e Sterilizimit. Infermier pranim urgjence. Laborant klinik biokimik /bakteriologjik.					
9	Infermier.		2%		51 100	
10	Kujdestar në Psikiatri.		2%		45 000	5 000
11	Kujdestar në Pediatri. Ndhmësinfermier.		2%		45 000	

Lidhja nr. 2 (kreu 2.4)

Struktura e pagave për laborantët në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Laborant		2%		61 200	

Lidhja nr. 2 (kreu 2.5)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore

(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermier		2%		63 600	
2	Infermier Ndhmësstomatolog		2%		51 100	

Lidhja nr. 2 (kreu 2.6)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore

(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Kryeinfermier urgjence		2%		63 600	2 000
2	Infermier urgjence		2%		60 400	2 000

Lidhja nr. 2 (Kreu 2.7)

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit në Njësinë e Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes
(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		<i>Paga e grupit (PG)</i>	<i>Shtesa për vjetërsi (SHV)</i>	<i>Shtesa për kualifikim (SHK)</i>	<i>Shtesa për pozicion (SHP)</i>	<i>Shtesa për kushte pune (SHKP)</i>
		1	2	3	4	5
1	Teknik i përgjithshëm Teknik elektrik		2%	0	45 000	

Lidhja nr. 2 (kreu 2.8)

(shtuar me Vkm nr. 794, datë 28.12.2023)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		<i>Paga e grupit (PG)</i>	<i>Shtesa për vjetërsi (SHV)</i>		<i>Shtesa për pozicion (SHP)</i>	<i>Shtesa për kushte pune (SHKP)</i>
		1	2		3	4
1	Kryeinfermier i përgjithshëm		2%		63 600	8 000
2	Kryeinfermier shërbimi në anestezi-reanimacion		2%		63 600	3 400
3	Kryeinfermier në shërbimin e urgjencës Infermier në hemodinamikë Kryelaborant bakteriolog Kryeinfermier në Shërbimet e kirurgjisë/në sallën e operacionit Kryeinfermier njësie/klinike në Fizioterapi		2%		63 600	1 800
4	Kryeinfermier në shërbimet universitare/terciar		2%		63 600	
5	Kryeinfermier në shërbimet e tjera		2%		60 400	
6	Kryelaborant imazherie		2%		60 600	1 800
7	Kryelaborant në Laboratorin Klinik Biokimik, Bakteriologjik. Kryeinfermier në Kirurgji/ Reanimacion/Sallë operacioni/Obstetrike/Gjinekologji		2%		60 600	1 500
8	Laborant histopatolog/Infermier në Reanimacion		2%		60 400	3 400
9	Infermier në punktin e gjakut. Infermier radiologji/endoskopi/teknik imazherie Infermier në kirurgji/Infermier salle		2%		53 300	1 800
10	Infermier pranim urgjence (njësia e koordinimit të urgjencës) Infermier në pneumologji/fizioterapi		2%		51 100	1 800
11	Teknik laborator/Logoped/Fizioterapist Infermier në shërbimet terciare Infermier/mami në obstetrike/gjinekologji Infermier në pediatri		2%		51 100	1 500
12	Infermier në shërbimet e tjera		2%		51 100	
13	Kujdestar		2%		45 000	

Vlera e pagës së grupit sipas nivelit arsimor

GRUPI	LLOJI I DIPLOMËS	PAGA NË LEKË
1	Master i Shkencave. Master i Arteve. Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	14000
2	Master Profesional. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	11000
3	Bachelor. Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.	10000
4	Diplomë e shkollës së mesme për personelin teknik të shkencave mjekësore, Lidhja nr. 2	8000
5	Dëftesë lirimi (arsimi 8/9 vjeçar) dhe kurse infermierie, për personelin teknik të shkencave mjekësore, Lidhja nr. 2	6000

Lidhja nr. 4

Struktura dhe nivelet e pagave për mjekët me tituj dhe grada shkencore

(ndryshuar lidhja nr. 4 me VKM nr. 466, datë 6.7.2022; me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

KUALIFIKIMI/GRADA/TITULLI SHKENCOR	PAGA (LEKË/MUAJ)	Shtesat
Shef shërbimi me titullin “Profesor”/“Profesor i asociuar”	159 000	52 400
Shef shërbimi me gradën shkencore “Doktor (PHD)”.	137 040	56 060
Profesor	155 400	51 700
Profesor i asociuar	135 000	55 100
Mjek me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	116 040	64 060

Lidhja nr. 5

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit me tituj akademikë, në

Institutin e Shëndetit Publik

(ndryshuar me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

Nr.	Pozicioni	Paga	Kushte pune
1	Zëvendëstitullar institucioni me titujt “Profesor”/ “Profesor i asociuar”	167 520	10 000
2	Zëvendëstitullar institucioni me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	159 000	10 000
3	Përgjegjës i Njesisë bazë me titujt “Profesor”/ “Profesor i asociuar”	159 000	10 000
4	Përgjegjës i Njesisë bazë nga kategoria “Lektor”	137 040	10 000
5	Përgjegjës sektori me titujt “Profesor”/ “Profesor i asociuar”	159 000	10 000
6	Përgjegjës sektori nga kategoria “Lektor”	137 040	10 000
7	Profesor	155 400	10 000
8	Profesor i asociuar	135 000	10 000
9	“Doktor (PHD)”	116 040	10 000
10	Mjekë me specializim afatgjatë	94 200	10 000

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e tjerë me arsim të lartë në Institutin e Shëndetit Publik

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE					
		Kategoria	Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesë për kushte pune
	1	2	3	4	5	6	
1	Titullar insitucioni	II-a	1	2%	0	118.100	10.000
2	Zëvendëstitullar ekonomik	III-a	1	2%	0	80.800	
3	Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes nga Rrezatimet. Drejtor i drejtorisë së shërbimeve mbështetëse	III-a	1	2%	0	80.800	
4	Përgjegjës sektori në njësitë e përmbajtjes pa tituj e grada.	III-a/1	1	2%	0	75.000	
5	Përgjegjës sektori mbështetës.	III-b	1	2%	0	61.000	
6	Specialist në njësitë e përmbajtjes pa tituj e grada.	III-b	1 ose 2 ose 3	2%	0	61.000	
7	Specialist në sektorët mbështetës.	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	0	38.000	

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin teknik të shkencave mjekësore në Institutin e Shëndetit Publik

(ndryshuar lidhja nr. 7 me vendimin nr. 466, datë 6.7.2022; me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)
		1	2	3	4	5
1	Laborant mikrobiologji teknike laborator/infermier në njësinë e epidemiologjisë dhe sëmundjeve infektive. Teknik imazherie.		2%	0	51 100	8 000
2	Laborant kimist, mikrobiolog, biokimist në njësinë e shëndetit dhe mjedisit dhe të vivariumit.		2%	0	53 300	3 700

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe personelin teknik të shkencave mjekësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës

(ndryshuar lidhja nr. 8 me vendimin nr. 466, datë 6.7.2022; me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		<i>Paga e grupit (PG)</i>	<i>Shtesa për vjetërsi (SHV)</i>	<i>Shtesa për kualifikim (SHK)</i>	<i>Shtesa për pozicion (SHP)</i>	<i>Shtesa për kushte pune (SHKP)</i>
		1	2	3	4	5
1	Shef shërbimi	1	2%	0	136 900	5 000
2	Mjek të specialiteteve të ndryshme	1	2%	0	118 300	4 000
3	Mjek të përgjithshëm Stomatolog Farmacist	1	2%	0	73 100	4 000
4	Kryeinfermier		2%	0	60 400	5 000
5	Infermier		2%	0	51 100	5 000

Lidhja nr. 9

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin mjekësor civil, në strukturat e Forcave të Armatosura të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes

(ndryshuar lidhja nr. 9 me vendimin nr. 466, datë 6.7.2022; me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		<i>Paga e grupit (PG)</i>	<i>Shtesa për vjetërsi (SHV)</i>	<i>Shtesa për kualifikim (SHK)</i>	<i>Shtesa për pozicion (SHP)</i>	<i>Shtesa për kushte pune (SHKP)</i>
		1	2	3	4	5
1	Mjek i përgjithshëm	1	2%	0	73 100	
2	Mjek të specialiteteve të tjera	1	2%	0	118 300	

Lidhja nr. 10

Shpërblimi për punonjësit e personelit të caktuar nga pala turke në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier dhe për punonjësit e personelit të palës turke të caktuar në pozicionet “Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale”

(ndryshuar me vendimin nr. 179, datë 30.3.2022; ndryshuar titulli i lidhjes, shtuar nënndarja 12 me VKM nr. 711, datë 11.11.2022; me VKM nr. 245, datë 20.4.2023)

	Emërtimi i pozicionit	Masa mujore e shpërblimit në lekë
1	Nëndrejtor (mjekësor)	300 000
2	Nëndrejtor (ekonomik)	250 000
6	Shef shërbimi	283 000
4	Mjekë të specialiteteve të ndryshme	306 000
5	Farmacist	172 000
6	Kryeinfermier i përgjithshëm	260 000
7	Infermier	205 000
8	Përgjegjës sektori	117 000
9	Specialist	120 000
10	Teknik biomedikal	110 000
11	Teknik të shkencave mjekësore (profile të ndryshme)	120 000
12	Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale (mjekësor)	310 000
13	Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale (ekonomik)	265 000

VENDIM
Nr.90, datë 6.2.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.424, DATË 26.6.2024,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE E SHTESAVE MBI PAGË, KOMPENSIMEVE
DHE TRAJTIMEVE TË TJERA FINANCIARE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT
SHËNDETËSOR, NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE, NË SISTEMIN E
MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË, NË STRUKTURAT
SHËNDETËSORE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE DHE TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr.35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.424, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave e shtesave mbi pagë, kompensimeve dhe trajtimeve të tjera financiare të punonjësve të sistemit shëndetësor, në institucionet shëndetësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat shëndetësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “c”, e pikave, 4.1, 4.2, 4.3, 14.1, 14.2 dhe 16.2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Shtesa për vjetërsi në punë që jepet në masën:

i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.”.

b) Pikat 17.1 dhe 17.2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“17.1 Për mjekët e spitaleve në shërbimet e urgjencës, në shërbimet e reanimacionit, në shërbimet e hemodinamikës, në njësinë e aksidenteve cerebrale dhe për mjekët neonatë, është në masën 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.”.

“17.2 Për punonjësit “infirmier”, “teknik imazherie” dhe “teknik laborator” të spitaleve në shërbimet e urgjencës, shërbimet e reanimacionit dhe shërbimet e hemodinamikës, njësinë e aksidenteve cerebrale, si dhe për punonjësit “mjek” dhe “infirmier” në shërbimin e urgjencës mjekësore paraspitalore, në Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, është në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.”.

c) Në pikën 17.5 bëhen shtesat e mëposhtme:

i. Në shkronjën “a”, pas fjalës “... Pukë ...” shtohet “... Fushë-Arës ...”;

ii. Në shkronjën “b”, pas fjalës “... Librazhd ...” shtohet “... Përrenjas ...”.

ç) Pika 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“19. Mjekët dhe punonjësit e personelit teknik të shkencave mjekësore të institucioneve të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe mjekët, civilë e ushtarakë, të strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e shërbimit të rojës dhe të shërbimit të urgjencës përfitojnë një shtesë, si më poshtë vijon.”.

d) Shkronja “b”, e pikës 19.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) për shërbimin e urgjencës së spitalit, që është organizuar dhe funksionon si i tillë, si dhe për shërbimin e urgjencës në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor, që ofrojnë shërbim të pandërprerë për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës, masa e shtesës përcaktohet, si më poshtë vijon:

	Në ditët e zakonshme	Në ditët e shtuna	Në ditët e diela dhe të festave zyrtare
për sistemin 24 orë	2 700 lekë	2 900 lekë	3 200 lekë
për sistemin 16 orë	2 400 lekë	2 700 lekë	2 900 lekë
për sistemin 12 orë	2 200 lekë	2 400 lekë	2 700 lekë

dh) Shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 19.2, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) për shërbimin e urgjencës së spitalit, si dhe për shërbimin e urgjencës në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor, që ofrojnë shërbim të pandërprerë për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës, u jepet një shtesë, në masën:

	Në ditët e zakonshme	Në ditët e shtuna	Në ditët e diela dhe të festave zyrtare
për sistemin 24 orë	2 000 lekë	2 500 lekë	3 000 lekë
për sistemin 16 orë	1 700 lekë	2 000 lekë	2 600 lekë
për sistemin 12 orë	1 400 lekë	1 700 lekë	2 000 lekë

“b) për rastet kur, me kërkesë të institucionit dhe miratim të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë e të ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen, punonjësve “technik laborator” të spitaleve, që kryejnë shërbim 24 orë, u jepet një shtesë mbi pagë, si më poshtë vijon:

për ditë të zakonshme	2 000 lekë
për ditët e shtuna	2 500 lekë
për ditët e diela dhe festa	3 000 lekë

e) Pika 22 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“22. Punonjësit e personelit “mjek” dhe “technik të shkencave mjekësore”, të cilët punojnë në institucionet shëndetësore, larg vendbanimit të tyre, marrin një kompensim mujor, në masën, si më poshtë vijon:”.

ë) Fjalja hyrëse, e pikës 22.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për personelin “mjek” dhe “technik të shkencave mjekësore” në qendrat shëndetësore të shërbimit parësor:”.

f) Pika 23 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“23. Titullarët e institucioneve, në varësi të ministrit për çështjet e shëndetësisë, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, me qëllim realizimin me efektivitet dhe eficiencë të misionit dhe objektivave të institucionit që drejtojnë, kanë të drejtë që për të marrë këshillimin e duhur për çështje specifike të kenë këshilltarë të jashtëm, me shtetësi shqiptare apo të huaj. Kontraktimi i këshilltarëve të jashtëm bëhet pas miratimit të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Pagesa e këshilltarëve të jashtëm bëhet nga llogaria ekonomike, e përcaktuar sipas udhëzimit përkatës të zbatimit të buxhetit të ministrit përgjegjës për financat dhe përcaktohet nga titullari përkatës, në masën deri në 112 750 (njëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj.

Numri i këshilltarëve të jashtëm, që mund të kontraktojnë titullarët e institucioneve në varësi të ministrit për çështjet e shëndetësisë, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, nuk duhet të jetë më i madh se 3 (tre).”.

g) Lidhjet nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.7, nr.9, nr.10 dhe nr.11 zëvendësohen me lidhjet me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vlerat e elementit “pagë për pozicion” apo “paga bazë mujore e pozicionit të punës”:

a) për pozicionet me numrat rendorë 19, 20 dhe 21, të lidhjes nr.1, pozicionet me numrin rendor 9, të kreut I, dhe numrin rendor 6, të kreut II, të lidhjes nr.2, pozicionet me numrat rendorë 15, 16 dhe 17, të lidhjes nr.3, pozicionet me numrin rendor 8, të kreut I, dhe numrin rendor 9, të kreut VII, të lidhjes nr.4, pozicionet me numrin rendor 3, të kreut I dhe numrin rendor 4, të kreut II, të lidhjes nr.7, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave;

b) për pozicionet e tjera në lidhjet nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.7, nr.9 dhe nr.10, të këtij vendimi, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5%.

3. Vlerat e shpërblimit mujor, të përcaktuar në lidhjen nr.11, për punonjësit e personelit të caktuar nga pala turke në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier, si dhe në pozicionet “Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale” janë rezultat i rregullimit të masës së këtij shpërblimi, për shkak të indeksimit të vlerës së elementit “paga e pozicionit” për pozicionet përkatëse ku aktualisht janë të punësuar këta punonjës, si dhe për shkak të ndryshimeve të kursit të këmbimit valutor.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga buxheti i miratuar për secilin nga institucionet, pjesë e fushës së veprimit të tij, të miratuara në ligjin nr.87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”.

5. Ngarkohen institucionet, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Lidhja nr. 1

Vlerat e elementeve “pagë për pozicion” për punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga “specialist” deri në “titullar institucioni” në institucionet e shërbimeve shëndetësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, të përcaktuara në nënpikën 3.1, të pikës 3, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimi	Grupi i diplomës	Paga për pozicion (lekë/muaj)
1	Titullar institucioni në QSU “Nënë Tereza”.	1	210,125
2	Titullar institucioni në: - Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”. - Spitalin rajonal “Memorial” Fier. - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë.	1	184,500
3	Titullar institucioni në: - Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik nr. 1 dhe nr. 2 Tiranë. Zëvendëstitullar institucioni: - në QSU “Nënë Tereza”.	1	174,250
4	Titullar institucioni në: - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë. - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Zëvendëstitullar institucioni në: - Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”. - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë. - Spitalin rajonal “Memorial” Fier.	1	164,000
5	Titullar institucioni në qendrat spitalore rajonale.	1	158,875

6	<p>Titullar institucioni në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Spitalet rajonale. - Spitalet psikiatrike. <p>-Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale (profili mjekësor /ekonomik).</p> <p>Konsulent mjekësor në spitalet universitare dhe terciare.</p> <p>Zëvendëstitullar institucioni në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik nr. 1, nr. 2 Tiranë. - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë. - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. 	1	144,525
7	Titullar institucioni në spitalet bashkiake.	1	141,450
8	Titullar institucioni në spitalet ditore. Zëvendëstitullar institucioni në qendrat spitalore rajonale.	1	133,250
9	Zëvendëstitullar institucioni në spitalet rajonale/psikiatrike. Drejtor drejtorie në QSU “Nënë Tereza”.	1	124,025
10	Zëvendëstitullar në spitalet bashkiake/ditore. Drejtor drejtorie në:	1	117,900
	<ul style="list-style-type: none"> - Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”. - Spitalin Rajonal “Memorial” Fier. - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë. 		
11	Drejtor drejtorie në Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr. 1, nr. 2 Tiranë. Administrator për Polin e Administrimit të Integruar në QSU “Nënë Tereza”.	1	107,700
12	Përgjegjës sektori biomedikal në spitalet universitare.	1	102,500
13	Drejtor drejtorie në qendrat spitalore rajonale. Përgjegjës sektori në :	1	97,400
	<ul style="list-style-type: none"> - spitalet universitare. - Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”. - në spitalin rajonal “Memorial” Fier. 		
14	Përgjegjës sektori në :	1	92,250
	<ul style="list-style-type: none"> - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. - Klinikën Stomatologjike Universitare. 		
15	Përgjegjës Sektori në qendrat spitalore rajonale.	1	87,200
16	Specialist në: QSU “Nënë Tereza”; Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, Spitalin Rajonal “Memorial” Fier.	1 ose 2 ose 3	87,200
17	Përgjegjës sektori në spitalet rajonale dhe psikiatrike.	1	82,000
18	Specialist në:	1 ose 2, ose 3	82,000
	<ul style="list-style-type: none"> - në Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr. 1, nr. 2 Tiranë. - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë. - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. 		
19	Përgjegjës sektori në spitalet bashkiake/ditore.	1	73,000
20	Specialist në:	1 ose 2, ose	73,000

	- qendrat spitalore rajonale - spitalet rajonale dhe psikiatrike.	3	
21	Specialist në spitalet bashkiake/ditore.	1 ose 2, ose 3	65,000

Lidhja nr. 2

Vlerat e elementit “pagë për pozicion” për personelin “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe “teknikë të shkencave mjekësore”, në institucionet e ofrimit të shërbimit shëndetësor, të përcaktuara në nënpikën 3.1, të pikës 3, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimi	Grupi i diplomës	Paga për pozicion (lekë/muaj)
Kreu I	Në spitalet universitare/terciare, në shërbimin universitar /terciar në Qendrën Spitalore Rajonale Tiranë “Shefqet Ndroqi” dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës		
	Për personelin “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë”		
1	Drejtuës mjekësor në QSU “Nënë Tereza”. Shef shërbimi.	1	164,000
2	Përgjegjës njësie/klinike/kabineti (mjek me specialitet) në shërbimin spitalor universitar/terciar.	1	149,650
3	Përgjegjës mjekësor në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (mjek me specialitet).	1	144,525
4	Mjekë me specialitet në: - shërbimin spitalor universitar/terciar. - Klinikën Stomatologjike Universitare. - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	138,400
5	Shef/përgjegjës farmacie. Përgjegjës në sektorin e infeksioneve spitalore (mjek).	1	122,000
6	Mjek i përgjithshëm/Stomatolog në shërbimet klinike. Gjenetist. Embriolog. Fizikant/ Biolog/ Kimist në: - në shërbimin spitalor universitar/terciar. - në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Farmacist. Specialist i shëndetit publik (mjek në sektorin e infeksioneve spitalore).	1	115,900
7	Specialist i shëndetit publik (në sektorin e infeksioneve spitalore).	1 ose 2	98,400
8	Psikolog/punonjës social/specialist fizikulture.	1 ose 2	96,350
	Për personelin “teknik të shkencave mjekësore”		
1	Kryeinfermier i përgjithshëm. Kryemami i përgjithshëm.	1 ose 2 ose 3	87,200
2	Kryeinfermier shërbimi/njësie/klinike, në shërbimin infektiv në QSU “Nënë Tereza”. Kryeinfermier shërbimi/Klinike/Njësi Psikiatrike. Kryeinfermier shërbimi në Terapi Intensive/Onkologjik/ Neurokirurgji.	1 ose 2 ose 3	84,050

	Kryelaborant në Histopatologji/Anatomi Patologjike. Kryeinfermier/Kryelaborant në Radioterapi/Imazheri dhe Mjekësi Nukleare. Kryeinfermier/kryemami njësie/klinike i Terapisë Intensive/ Strokë dhe Poststrokë. Kryeinfermier në Hemodinamikë/Kemioterapi.		
3	Kryeinfermier shërbimi. Kryemami shërbimi. Kryelaborant shërbimi.	1 ose 2 ose 3	82,410
4	Infermier në Hemodinamikë.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	82,410
5	Infermier/laborant në psikiatri. Laborant histopatolog. Infermier/mami në Reanimacion/Neonatologji. Infermier në Kimioterapi/dhomën e zgjimit.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	79,500
6	Kryeinfermier njësie/klinike pranim në urgjencë. Kryeinfermier/ kryemami / kryelaborant.	1 ose 2 ose 3	72,000
7	Laborant radiolog në Onkologji. Laborant në Radioterapi/në Mjekësinë Nukleare. Laborant klinik biokimik. Laborant radiolog. Laborant në neurofiziologji. Infermier në Punktin e gjakut/ Hematologji/ Hemodializë/ Onkologji/Endoskopi/Toksikologji. Infermier/laborant bakteriolog /imunolog. Infermier njësie/klinike Radiologji/Angio CT. Teknik imazherie dhe Angio CT. Infermier në Kirurgji/Maksilofaciale/Neurokirurgji/ Kardiokirurgji/Djegje plastike. Infermier/mami në Obsetrikë/ Gjinekologji/Patologji barre/ Neonatologji. Infermier salle. Infermier/laborant në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	72,000
8	Infermier në njësinë e radioterapisë dhe mjekësisë nukleare/ në litotripsi. Infermier në Shërbimin Infektiv në QSU “Nënë Tereza”. Infermier pranim urgjence (njësia e koordinimit të urgjencës). Infermier në fizioterapi. Laborant/infermier/mami/logoped. Prozektor.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	70,800
9	Kujdestar. Oksigjenist.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	63,000
Kreu II	Në shërbimet e tjera në qendrën spitalore rajonale Tiranë “Shefqet Ndroqi”, në qendrat spitalore rajonale, në spitalet rajonale/psikiatrike/bashkiake/ditore		
	Për personelin “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë”		
1	Zëvendës drejtor mjekësor/ shef shërbimi (mjek me specialitet).	1	140,500
2	Përgjegjës njësie/klinike/	1	

	Kabineti/Poliklinike/Laboratori, (mjek me specialitet). Përgjegjës i Bankës së Gjakut.		127,100
3	Mjek me specialitet.	1	122,000
4	Përgjegjës/Shef farmacie.	1	115,900
5	Shef/përgjegjës njësie/klinike (mjek i përgjithshëm).	1	102,500
6	Mjek i përgjithshëm. Stomatolog. Farmacist. Kimist/fizikan/biolog.	1	98,400
7	Specialist i shëndetit publik (në sektorin e infeksioneve spitalore).	1 ose 2 ose 3	87,200
8	Psikolog, Punonjës social.	1 ose 2 ose 3	82,000
	Për personelin “teknik të shkencave mjekësore”		
1	Kryeinfermier i përgjithshëm. Kryeinfermier njësie/klinike në spitalet psikiatrike.	1 ose 2 ose 3	82,000
2	Kryeinfermier. Kryelaborant.	1 ose 2 ose 3	79,000
3	Laborant në Anatominë Patologjike.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	76,900
4	Kryeinfermier në poliklinikën e spitalit.	1 ose 2 ose 3	70,800
5	Infermier/ laborant në Psikiatri. Infermier. Laborant. Fizioterapist. Logopedist. Përgjegjës turni. Ndhimësanestezist. Ndhimësfarmacist. Prozektor.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	70,800
6	Kujdestar. Ndhimësinfermier. Oksigjenist.	4 ose 5	63,000

Lidhja nr. 3

Vlerat e elementeve “pagë për pozicion” për punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga “specialist” deri në “titullar institucioni”, në institucionet shëndetësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë të përcaktuara në nënpikat 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimet e pozicioneve të punës	Grupi i diplomës	Paga për pozicion (lekë/ muaj)
1	Titullar institucioni në: - Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.	1	184,500
2	Titullar institucioni në: - Qendrën Kombëtare të Trajtimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve. - Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore.	1	174,250
3	Titullar institucioni në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore. Zëvendëstitullar institucioni në: - Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor. - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore. - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.	1	158,875
4	Zëvendëstitullar institucioni në:	1	

	- Qendrën Kombëtare të Trajtimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve. - Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore.		144,525
5	Titullar institucioni në drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.	1	138,400
6	Titullar institucioni në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në qarqe.	1	133,250
7	Drejtor në drejtoritë e përmbytjes në: - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore. - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.	1	131,200
8	Titullar institucioni në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në bashki. Drejtor drejtorie në Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.	1	128,200
9	Drejtor në drejtoritë e përmbytjes në Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore. Drejtor në drejtorinë mbështetëse në: - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore. - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.	1	117,900
10	Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor. Përgjegjës i sektorëve të përmbytjes në: - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore. - Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore. Përgjegjës sektori në Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.	1	102,500
11	Përgjegjës i sektorëve mbështetës në: - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. - Qendrën Kombëtare të Trajtimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve. Përgjegjës sektori në: - Drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor. - Njësitë vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në qarqe.	1	92,250
12	Përgjegjës sektori në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në bashki. Specialist (inxhinier/IT/biomedikal) në Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore	1	87,200
13	Përgjegjës i sektorëve mbështetës në: - Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore. - Qendrën e Shërbimeve Mjekësore.	1	82,000
14	Specialist promocioni në Qendrën Kombëtare të Trajtimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve. Specialist, (niveli i parë) në Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.	1 ose 2 ose 3	82,000
15	Specialist finance (nëpunës zbatues) në qendrat shëndetësore të specialiteteve /qendrat shëndetësore.	1	73,000
16	Specialist në: - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore; - Qendrën Kombëtare të Trajtimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve; - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;	1 ose 2 ose 3	73,000

	- Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore; - Qendrën e Shërbimeve Mjekësore; - Specialist, niveli i dytë në Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.		
17	Specialist në: - njësitë vendore të kujdesit shëndetësor; - qendrat shëndetësore të specialiteteve/qendrat shëndetësore.	1 ose 2 ose 3	68,000

Lidhja nr. 4

Vlerat e elementit “pagë për pozicion”, për personelin “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe “teknikë të shkencave mjekësore”, në institucionet shëndetësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, të përcaktuara në nënpikat 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimi	Grupi i diplomës	Paga për pozicion (lekë/muaj)
Kreu I	Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët		
1	Shef shërbimi (mjek me specialitet)	1	140,500
2	Mjek me specialitet	1	124,100
3	Mjek i përgjithshëm në shërbimin klinik	1	98,400
4	Specialist psikolog, punonjës social/pedagogji e specializuar.	1 ose 2 ose 3	92,250
5	Terapist/fizioterapist/logopedist	1 ose 2 ose 3	91,300
6	Kryeinfermier	1 ose 2 ose 3	77,900
7	Infermier	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	68,800
8	Kujdestar	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	63,000
Kreu II	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore		
1	Përgjegjës/Shef sektori në sektorët e përmbytjes për kontrollin e barnave dhe pajisjeve mjekësore.	1	115,900
2	Farmacist. Analist. Mjek. Inxhinier për pajisjet mjekësore. Inspektor për Kontrollin Farmaceutik	1	108,200
3	Laborant	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	79,000
Kreu III	Qendra e Shërbimeve Mjekësore		
1	Mjek me specialitet	1	122,000
2	Mjek i përgjithshëm. Stomatolog	1	98,400
3	Kryeinfermier	1 ose 2 ose 3	81,000
4	Infermier. Ndihmës stomatolog	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	68,800
Kreu IV	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore		
1	Mjek (urgjence). Specialist (shkenca mjekësore)	1	117,900
2	Farmacist	1 ose 2 ose 3	98,400

3	Kryeinfermier urgjence	1 ose 2 ose 3	83,100
4	Infermier urgjence	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	79,950
Kreu V	Njësitë vendore të kujdesit shëndetësor		
1	Shef shërbimi (mjek me specialitet) që punojnë në shërbimet e shëndetit publik. Përgjegjës në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër dhe shërbimet komunitare (mjek psikiatër).	1	130,200
2	Shef shërbimi (mjek).	1	128,640
3	Mjek me specialitet që punojnë në shërbimet e shëndetit publik. Mjek psikiatër në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor. Mjek psikiatër që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër dhe shërbimet komunitare.	1	122,000
4	Përgjegjës/shef në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër dhe shërbimet komunitare (punonjës social psikolog).	1	107,700
5	Mjek. Stomatolog.	1	98,400
6	Psikolog/punonjës social që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor.	1	84,050
7	Specialist në shërbimet e shëndetit publik. Specialist në sektorin e shërbimit parësor.	1 ose 2 ose 3	79,000
8	Kryeinfermier/kryevaksinator.	1	77,900
9	Teknik specialitetesh shëndetësore. Infermier/terapist në shërbimet e shëndetit mendor. Infermier.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	71,300
Kreu VI	Instituti i Shëndetit Publik		
1	Mjek me specialitet.	1	122,000
2	Laborant kimist, mikrobiolog, biokimist në njësinë e shëndetit dhe mjedisit dhe të vivariumit.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	70,300
3	Laborant mikrobiologji teknike laborator/infermier në njësinë e epidemiologjisë dhe sëmundjeve infektive. Teknik imazherie.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	68,300
Kreu VII	Qendrat shëndetësore të kujdesit parësor		
1	Mjek të specializuar që punojnë në specialitete dhe në mjekësi familjare	1	127,100
2	Mjeke të përgjithshëm që punojnë në mjekësi familjare	1	112,750
3	Mjek i përgjithshëm që punon në specialitete	1	97,400
4	Kimist	1 ose 2 ose 3	76,900
5	Psikolog/punonjës social	1 ose 2 ose 3	73,800
6	Kryeinfermier/kryemami	1 ose 2 ose 3	70,800
7	Laborant bakterologjik / klinik biokimik, logoped. Infermiere (hematologji, onkologji). Laborant rëntgeni. Infermier ortopedi. Infermier/laborant në fizioterapi. Orthopist. Infermiere në kirurgjinë vazale	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	70,800

8	Infermier/mami. Ndihmës bakterolog	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	65,800
9	Ndihmës infermier	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	63,000

Lidhja nr. 7

Vlerat e elementeve “pagë për pozicion” dhe “shtesë për kushte pune” për punonjësit e personelit “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe “teknikë të shkencave mjekësore”, në institucionet e tjera të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, të përcaktuara në nënpikat 3.5, të pikës 3, të këtij vendimi.

Nr.	Emërtimi	Grupi i diplomës	Paga për pozicion (lekë/muaj)	Shtesa për kushte pune (lekë/muaj)
Kreu I	Në Qendrën spitalore të burgjeve dhe në shërbimin shëndetësor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve			
1	Shef shërbimi	1	140,500	5,000
2	Mjek të specialiteteve të ndryshme	1	122,000	4,000
3	Mjek të përgjithshëm. Stomatolog. Farmacist.	1	98,400	4,000
4	Kryeinfermier	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	78,700	5,000
5	Infermier	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	68,800	5,000
Kreu II	Në Njësinë e Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë në strukturat e ministrisë së Mbrojtjes			
1	Kryepilot	1	107,700	10,000
2	Pilot	1	102,500	10,000
3	Teknik Helikopteri fluturues	1	92,250	
4	Teknik i përgjithshëm. Teknik elektrik.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	63,000	
Kreu III	Për punonjësit civilë të personelit mjekësor dhe të personelit teknik të shkencave mjekësore, në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të sistemit të ministrisë së Mbrojtjes			
1	Mjek të specialiteteve të tjera	1	122,000	
2	Mjek i përgjithshëm	1	98,400	
3	Infermier	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	68,800	
Kreu IV	Për punonjësit e personelit mjekësor civilë, në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit			
1	Shef shërbimi	1	140,500	
2	Mjek të specialiteteve të ndryshme	1	122,000	
3	Mjek të përgjithshëm. Stomatolog. Farmacist.	1	98,400	

4	Kryeinfermier	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	77,900	
5	Infermier/laborant	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	68,800	

Lidhja nr. 9

Vlerat e elementeve “paga bazë mujore e pozicionit të punës” dhe “shtesë për kushte pune” për mjekë dhe teknikë të shkencave mjekësore, me tituj e grada shkencore, të cilët janë punonjës efektivë me kohë të plotë, në QSUNT, spitalet universitare, Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, spitalin “Memorial” Fier, si dhe në Klinikën Stomatologjike Universitare

	Kualifikimi/grada/titulli shkencor	Paga bazë mujore e pozicionit të punës (lekë/muaj)	Shtesë për kushte pune (lekë/muaj)
1	Shef shërbimi me titullin “Profesor”/“Profesor i asociuar”.	163,000	52,400
2	Shef shërbimi me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	140,490	56,060
3	Profesor	159,300	51,700
4	Profesor i asociuar	138,400	55,100
5	Mjek me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	118,940	64,060
6	Teknik i shkencave mjekësore (në njësinë e ortopedisë në SUT) me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	96,350	15,000

Lidhja nr. 10

Vlerat e elementeve “paga bazë mujore e pozicionit të punës” dhe “shtesë për kushte pune” për mjekët dhe punonjësit e tjerë, me tituj e grada shkencore, të cilët janë punonjës efektivë me kohë të plotë, në Institutin e Shëndetit Publik

Nr .	Pozicioni	Paga bazë mujore e pozicionit të punës	Shtesë për kushte pune (lekë/muaj)
1	Zëvendës titullar institucioni me titujt “Profesor”/ “Profesor i asociuar”	171,720	10,000
2	Zëvendës titullar institucioni me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	163,000	10,000
3	Përgjegjës i Njesisë bazë me titujt “Profesor”/“Profesor i asociuar”	163,000	10,000
4	Përgjegjës i Njesisë bazë me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	140,490	10,000
5	Përgjegjës sektori me titujt “Profesor”/“Profesor i asociuar”	163,000	10,000
6	Përgjegjës sektori me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	140,490	10,000

7	Profesor	159,300	10,000
8	Profesor i asociuar	138,400	10,000
9	Doktor (PHD)	118,940	10,000

Lidhja nr. 11

Shpërblimi për punonjësit e personelit të caktuar nga pala turke në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier dhe për punonjësit e personelit të palës turke të caktuar në pozicionet “Menaxher spitalor” në spitalet universitare e rajonale”

Nr.	Emërtimi i pozicionit	Masa mujore e shpërblimit (lekë/muaj)
1	Nëndrejtor (mjekësor)	279,750
2	Nëndrejtor (ekonomik)	229,750
3	Shef shërbimi	278,800
4	Mjekë të specialiteteve të ndryshme	302,200
5	Mjekë në Anestezi-Reanimacion/Urgjencë/Hemodinamikë	284,200
6	Farmacist	169,100
7	Kryeinfermier i përgjithshëm	236,400
8	Infermier	186,300
9	Infermier në shërbimin e Anestezi-Reanimacionit	174,200
10	Infermier në shërbimin e Hemodinamikës	174,190
11	Infermier në shërbimin e Urgjencës	174,400
12	Menaxher Spitalor (Mjekësor)	291,475
13	Menaxher Spitalor (Ekonomik)	246,475
14	Drejtor Drejtorie (që punon me teknologjinë e informacionit)	107,100
15	Specialist IT (që punon me teknologjinë e informacionit)	107,800

VENDIM
Nr. 87, datë 6.2.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 326, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “a” e “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, të vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vlerat e elementit “paga bazë për klasë”, në lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave për punonjësit, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga buxheti i institucioneve përkatëse, miratuar në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”.

4. Ngarkohen institucionet, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja I

Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij vendimi

Nr. rendor	Klasa e pagës	Paga bazë për klasë
1	I	50 000
2	II	51 000
3	III	51 800
4	IV	52 500
5	V	53 000
6	VI	54 000
7	VII	55 500
8	VIII	56 300
9	IX	57 000

Lidhja II

Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij vendimi

Nr. rendor	Klasa e pagës	Paga bazë për klasë
1	I	50 000
2	II	51 000
3	III	51 800
4	IV	52 500
5	V	52 800
6	VI	53 200
7	VII	53 600
8	VIII	54 100
9	IX	54 800
10	X	55 300
11	XI	55 700
12	XII	56 000
13	XIII	56 700

VENDIM
Nr. 424, datë 26.6.2024

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE E SHTESAVE MBI PAGË, KOMPENSIMEVE DHE TRAJTIMEVE TË TJERA FINANCIARE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT SHËNDETËSOR, NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE, NË SISTEMIN E MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR SHËNDETËSINË, NË STRUKTURAT SHËNDETËSORE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE DHE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

- a) personeli “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe personeli “teknikë të shkencave mjekësore” në institucionet shëndetësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;
- b) mjekët në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe në institucionet e përkujdesjes sociale, të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;
- c) personeli “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe personeli “teknikë të shkencave mjekësore” në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës;
- ç) personeli ushtarak “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe teknikë të shkencave mjekësore” në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, vetëm për efekt të kryerjes së shërbimeve (rojë, gatishmëri, urgjencë);
- d) personeli civil “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe “teknikë të shkencave mjekësore” në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes;
- dh) personeli i Njësisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes;
- e) personeli “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe personeli “teknikë të shkencave mjekësore” në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe në Qendrën Spitalore të Burgjeve;
- ë) personeli civil “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe personeli “teknikë të shkencave mjekësore” në strukturat shëndetësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Mjek” përfshin të gjithë profesionistët e shëndetësisë, që janë të licencuar për ushtrimin e profesionit të mjekut nga “Urdhri i mjekut” apo “Urdhri i stomatologut” dhe që ushtrojnë profesionin e tyre si “mjek i përgjithshëm”, “mjek i specializuar” dhe “stomatolog”;
- b) “Punonjës të tjerë me arsim të lartë” përfshin punonjësit e profesioneve të ndryshme me arsim të lartë (referuar nivelit 6 dhe 7 të kornizës shqiptare të kualifikimeve), si farmacistë, kimistë, fizikanë, inxhinierë, biologë, specialistë të shëndetit publik, psikologë, punonjës socialë dhe specialistë të fizikulturës, të cilët janë pjesë e strukturave shëndetësore për parandalimin e sëmundjeve dhe trajtimin mjekësor të pacientëve;
- c) “Personeli teknik i shkencave mjekësore” përfshin të gjithë profesionistët, që janë të licencuar nga urdhri përkatës dhe që ushtrojnë profesionin e tyre, si: “fizioterapist”, “infermier”, “logoped”,

“mami”, “ndihmësfarmacist”, “ndihmësanestezist”, “teknik imazherie”, “teknik laborator”, dhe punonjës të tjerë në strukturat shëndetësore, si: “prozektor”, “kujdestar” e “oksigjenist”.

3. Në institucionet dhe strukturat shëndetësore, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, përfshihen:

3.1 institucionet shëndetësore të shërbimit spitalor dhe të barazuara me to, për efekt page, të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet shëndetësore të shërbimit spitalor të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, si:

- a) strukturat shëndetësore universitare;
- b) Njësia Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës;
- c) Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi”;
- ç) spitalet e nivelit terciar;
- d) qendrat spitalore rajonale;
- dh) spitalet rajonale;
- e) spitalet psikiatrike;
- ë) spitalet bashkiake;
- f) spitalet ditore;
- g) Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut;
- gj) Klinika Stomatologjike Universitare.

3.2 institucionet shëndetësore qendrore/kombëtare të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si:

- a) Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
- b) Instituti i Shëndetit Publik;
- c) Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe njësitë vendore të kujdesit shëndetësor;
- ç) Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët;
- d) Qendra e Inxhinierisë Biomjekësore;
- dh) Qendra e Shërbimeve Mjekësore;
- e) Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore.

3.3 Institucionet e ofrimit të shërbimit të kujdesit parësor të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

3.4 Institucionet e shërbimit social shtetëror, të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, vetëm për mjekët, në:

- a) drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
- b) institucionet e përkujdesjes sociale.

3.5 Institucione të tjera të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, si:

a) Qendra Spitalore e Burgjeve dhe shërbimet shëndetësore në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve;

b) strukturat e shërbimit shëndetësor, pjesë e strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes;

c) strukturat e shërbimit shëndetësor, në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

ç) Njësia e Helikopterëve të Transportit Mjekësor, të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore për punonjësit e institucioneve, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi janë, si më poshtë vijon:

4.1 Për personelin e administrimit të përgjithshëm, nga “specialist” deri në “titullar institucioni”, të institucioneve pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, me përjashtim të institucioneve të përmendura në nën pikën “3.5”, të pikës 3, të këtij vendimi:

a) paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune, është sipas lidhjeve përkatëse nr. 1 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

b) shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome është sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) shtesa për vjetërsi në punë, që jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 (njëzet e pesë) vjet dhe llogaritet mbi vlerën e shtesës së nivelit të kualifikimit, për çdo grup diplome.

4.2 Për personelin “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe për personelin “teknikë të shkencave mjekësore” në institucionet shëndetësore, të përcaktuara në nënpikat 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.5, të pikës 3, të këtij vendimi, me përjashtim të personelit mjekësor me grada shkencore dhe tituj akademikë, të Institutit të Shëndetit Publik dhe të spitaleve universitare, të disa institucioneve të tjera shëndetësore, që gëzojnë statusin e qendrave kërkimore shkencore, si dhe me përjashtim të mjekëve në nënpikën 3.4, të pikës 3, të këtij vendimi:

a) paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune dhe që është sipas lidhjeve përkatëse të këtij vendimi;

b) shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome është sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) shtesa për vjetërsi në punë, që jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 (njëzet e pesë) vjet dhe llogaritet mbi vlerën e shtesës së nivelit të kualifikimit, për çdo grup diplome;

ç) shtesa për kushte pune, e përcaktuar sipas lidhjeve nr. 5 dhe nr. 6, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

d) shtesa për natyrë të veçantë pune, që aplikohet për disa pozicione që kanë një natyrë të veçantë, të përcaktuara në tekstin e këtij vendimi.

4.3 Për mjekët që janë punonjës efektivë me kohë të plotë në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të cilët bëjnë vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe biopsiko-sociale dhe në institucionet e përkujdesjes sociale, pavarësisht specialitetit që kanë dhe të cilët janë përcaktuar në nënpikën 3.4, të pikës 3, të këtij vendimi:

a) paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune, vlera e së cilës është e njëjtë me vlerën e pagës për pozicion të pozicionit “mjek i përgjithshëm që punon në specialitete”, e përcaktuar në pikën 3, të kreut VII, të lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome është sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) shtesa për vjetërsi në punë që jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 (njëzet e pesë) vjet dhe llogaritet mbi vlerën e shtesës së nivelit të kualifikimit, për çdo grup diplome.

4.4 Për mjekët me tituj e grada shkencore, të cilët janë punonjës efektivë me kohë të plotë, në spitalet universitare dhe në institucione të tjera shëndetësore, që gëzojnë statusin e qendrave kërkimore-shkencore, (në bazë të legjislacionit përkatës për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, dhe të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave) në Institutin e Shëndetit Publik dhe në spitalin “Memorial” Fier, dhe për personelin “teknik i shkencave mjekësore”, në njësinë e ortopedisë në Spitalin Universitar të Traumës, elementet përbërëse të pagës bruto mujore janë, si më poshtë vijon:

a) paga bazë mujore e pozicionit të punës, e përcaktuar sipas titullit akademik apo gradës shkencore, sipas lidhjeve nr. 9 dhe nr. 10, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij;

b) shtesa për vjetërsi në punë, që aplikohet në masën 0.5% për çdo vit pune, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet dhe llogaritet mbi vlerën e pagës bazë mujore të pozicionit të punës;

c) shtesa për kushte pune, që përcaktohet sipas lidhjeve nr. 9 dhe nr. 10, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

5. Vlerat e elementit “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës për punonjësit e administrimit të përgjithshëm, nga “specialist” deri në “titullar institucioni”, në institucionet e shërbimit

shëndetësor, të përcaktuara në nënpikën 3.1, të pikës 3, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Vlerat e elementit “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës për personelin “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe “teknikë të shkencave mjekësore” në institucionet e shërbimit shëndetësor, të përcaktuara në nënpikën 3.1, të pikës 3, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Vlerat e elementit “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës për punonjësit e administrimit të përgjithshëm, nga “specialist” deri në “titullar institucioni”, në institucionet shëndetësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, të përcaktuara në nënpikat 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Vlerat e elementeve “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës për personelin “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe “teknikë të shkencave mjekësore” në institucionet shëndetësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, të përcaktuara në nënpikat 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Vlerat e elementit “shtesë për kushte pune” për punonjësit e personelit “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” në institucionet e përcaktuara në nënpikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Vlerat e elementit “shtesë për kushte pune” për punonjësit e personelit “teknikë të shkencave mjekësore”, në institucionet e përcaktuara në nënpikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi janë sipas lidhjes nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Vlerat e elementeve “pagë për pozicion”, grupi i diplomës dhe “shtesë për kushte pune” për punonjësit e personelit “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe “teknikë të shkencave mjekësore” në institucionet e tjera të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, të përcaktuara në nënpikën 3.5, të pikës 3, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

12. Vlerat e elementeve “paga bazë mujore e pozicionit të punës” dhe “shtesë për kushte pune” për mjekët me tituj e grada shkencore, të cilët janë punonjës efektivë me kohë të plotë në spitalet universitare dhe në institucione të tjera shëndetësore, që gëzojnë statusin e qendrave kërkimore-shkencore, (në bazë të legjislacionit përkatës për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor e të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave) në spitalin “Memorial” Fier dhe për personelin “teknik i shkencave mjekësore” në njësinë e ortopedisë në Spitalin Universitar të Traumës, me gradën shkencore “Doktor”, janë sipas lidhjes nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

13. Vlerat e elementeve “paga bazë mujore e pozicionit të punës” dhe “shtesë për kushte pune” për mjekët dhe punonjësit e tjerë, me tituj e grada shkencore, të cilët janë punonjës efektivë me kohë të plotë në Institutin e Shëndetit Publik, janë sipas lidhjes nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

14. Pagat dhe shtesat mbi pagë për mjekët dhe punonjësit e personelit teknik të shkencave mjekësore, të cilët për një periudhë të caktuar kohore gjatë sezonit veror, jo më të gjatë se tre muaj, kontraktohen/caktohen me afat të caktuar në qendrat shëndetësore verore, që hapen si shtesë e qendrave shëndetësore dhe, që, në bazë të urdhrorit të ministrit përgjegjës për çështjet e shëndetësisë, do të ofrojnë shërbim mjekësor të pandërprerë/24 orë, gjatë këtij sezoni, do të jenë si vijon:

14.1 Për mjekët:

a) paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune, vlera e së cilës është e njëjtë me vlerën e pagës për pozicion të pozicionit “mjek i përgjithshëm që punon në specialitete”, e përcaktuar në pikën 3, të kreut VII, të lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome është sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) shtesa për vjetërsi në punë që jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 (njëzet e pesë) vjet dhe llogaritet mbi vlerën e shtesës së nivelit të kualifikimit, për çdo grup diplome;

ç) shtesa për natyrë të veçantë pune, në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë në muaj.

Mjekët, paga e të cilëve përcaktohet sipas shkronjave “a” deri në “ç”, të kësaj nënpike, gjatë kësaj periudhe nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë, si dhe nuk përfitojnë kompensimin për largësi nga vendbanimi, sipas përcaktimeve të ndryshme, të këtij vendimi.

14.2 Për punonjësit e personelit “teknik të shkencave mjekësore”:

a) paga e pozicionit, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune, vlera e së cilës është e njëjtë me vlerën e pagës për pozicion të pozicionit “infirmier/mami”, e përcaktuar në pikën 8, të kreut VII, të lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome është sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) shtesa për vjetërsi në punë, që jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 (njëzet e pesë) vjet dhe llogaritet mbi vlerën e shtesës së nivelit të kualifikimit, për çdo grup diplome;

ç) shtesa për natyrë të veçantë pune, në masën 80 000 (tetëdhjetë) mijë lekë në muaj. Punonjësit e personelit “teknik të shkencave mjekësore”, paga e të cilëve përcaktohet sipas shkronjave “a” deri në “ç”, të kësaj nënpike, gjatë kësaj periudhe nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë, si dhe nuk përfitojnë kompensimin për largësi nga vendbanimi, sipas përcaktimeve të ndryshme, të këtij vendimi.

15. Mjekët e sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe mjekët civilë të strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët, referuar detyrimit kontraktual me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, kryejnë specializimin në strukturat spitalore universitare, gjatë kohës së specializimit trajtohen në pagë, si më poshtë vijon:

a) për specializantët “mjek familjeje” dhe “mjek urgjence”, në masën 100 për qind të pagës bruto mujore të mjekut të të njëjtit specialitet;

b) për specializantët e tjerë, në masën 80 për qind të pagës bruto mujore të mjekut të fushës, në të cilën kryhet specializimi.

16. Për punonjësit e personelit mjekësor, të cilët nuk janë efektivë me kohë të plotë në institucionet e shërbimit spitalor/parësor dhe në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe/apo në institucionet e përkujdesjes sociale, të cilët për shërbimin që kryejnë në këto institucione, kontraktohen me orë pune të caktuara, vlera e pagesës është, si më poshtë vijon:

16.1 Për punonjësit e personelit mjekësor në institucionet e shërbimit spitalor dhe parësor, të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë e të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, vlera e pagesës së një ore pune të kontraktuar është e njëjtë me vlerën orare të pozicionit të punës, për të cilin është kontraktuar.

16.2 Për mjekët, në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe në institucionet e përkujdesjes sociale, vlera e pagesës së një ore pune të kontraktuar është e njëjtë me vlerën orare të pozicionit “mjek i përgjithshëm që punon në specialitete”, e përcaktuar në pikën 3, të kreut VII, të lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Paga bruto e këtij pozicioni, për efekt të llogaritjes së pagës orare, për këto raste, do të llogaritet si shumë e elementeve:

a) paga për pozicion, vlera e së cilës është e njëjtë me vlerën e pagës për pozicion të pozicionit “mjek i përgjithshëm që punon në specialitete”, e përcaktuar në pikën 3, të kreut VII, të lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) shtesa e nivelit të kualifikimit, vlera e së cilës për çdo grup diplome, është sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) shtesa për vjetërsi në punë, që jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 (njëzet e pesë) vjet dhe llogaritet mbi vlerën e shtesës së nivelit të kualifikimit, për çdo grup diplome.

17. Masa e shtesës për natyrë të veçantë pune, për disa kategori të punonjësve të personelit mjekë dhe/apo teknikë të shkencave mjekësore përcaktohet, si më poshtë vijon:

17.1 Për mjekët e spitaleve në shërbimet e urgjencës, reanimacionit, hemodinamikës, në njësinë e aksidenteve cerebrale, si dhe për mjekët neonatë është në masën 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

17.2 Për punonjësit “infirmier”, “teknik imazherie” dhe “teknik laborator” të spitaleve në shërbimet e urgjencës, të reanimacionit dhe hemodinamikës, si dhe në njësinë e aksidenteve cerebrale është në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

17.3 Për mjekët, të cilët në zbatim të sistemit të referimit, dërgohen për konsulta dhe/apo për ndërhyrje kirurgjikale në spitale të tjera, përfitojnë për çdo ditë shërbimi një shtesë në pagë, si më poshtë vijon:

a) kur janë pjesë e strukturave shëndetësore universitare/terciare, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në ditë;

b) kur janë pjesë e strukturave shëndetësore të qendrave spitalore rajonale/spitaleve rajonale, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në ditë.

17.4 Për mjekët, të cilët, referuar statutit të qendrës shëndetësore, miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, caktohen drejtues të qendrave shëndetësore:

a) në qendrat shëndetësore nr. 1 deri në nr. 10, në Bashkinë Tiranë, si dhe në qendrat shëndetësore të specialiteteve nr. 1 deri në nr. 3, në Bashkinë Tiranë, në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj;

b) në qendrat shëndetësore në njësitë e tjera administrative, me vendndodhje në zonat urbane, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj;

c) në qendrat shëndetësore në njësitë e tjera administrative, me vendndodhje në zonat rurale, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.

17.5 Për mjekët që mbulojnë mjekësinë familjare në qendrat shëndetësore të shërbimit parësor, në njësitë administrative në zonat rurale, të bashkive:

a) Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj;

b) Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

17.6 Për mjekët që punojnë në institucionet shëndetësore me shtretër:

a) Pukë, Tropojë, Kukës, Has, Malësi e Madhe, Dibër, Bulqizë, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj;

b) Mat, Mirditë, Gramsh, Librazhd, në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj.

17.7 Pilotët dhe teknikët e strukturës së Njësisë së Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, për çdo fluturim përfitojnë shtesën, në masën 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë.

18. “Specialistët”, “përgjegjësit e sektorit” apo “drejtorët e drejtorive” të kujdesit shëndetësor të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, të cilët punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të shërbimit shëndetësor dhe në strukturat biomjekësore dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme diplomë universitare të nivelit “Master i shkencave”, “Master profesional”, “Bachelor” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “inxhinieri elektronike”, “inxhinieri informatike”, “informatikë”, “inxhinieri telekomunikacioni”, “teknologji informacioni”, “informatikë ekonomike”, “informatikë biznesi”, “inxhinieri matematike informatike”, “shkenca kompjuterike”, “inxhinieri matematike” (në analiza sistemesh), “inxhinieri biomjekësore”, “inxhinieri mekatronike”, “inxhinieri fizike në mjekësi” përfitojnë shtesën për kushte pune në masën:

a) 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj për nëpunësit e strukturave të TIK-ut dhe atyre biomjekësore, të institucioneve qendrore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë,

qendrat spitalore universitare, Spitalin Rajonal “Memorial” Fier dhe në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”;

b) 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj për nëpunësit e strukturave të TIK-ut dhe atyre biomjekësore, të spitaleve rajonale apo bashkiake, të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

Zbatimi i shtesave, si më sipër për pozicionet konkrete, bëhet pas miratimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, sipas përshkrimit të pozicionit të punës. Përfshihen nga ky parashikim nëpunësit e strukturave të TIK-ut të institucioneve të kujdesit shëndetësor të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, që janë bërë pjesë e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

19. Mjekët dhe punonjësit e personelit teknik të shkencave mjekësore të institucioneve të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe mjekët, civilë e ushtarakë, të strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e shërbimit të rojës, të gatishmërisë dhe urgjencës përfitojnë një shtesë, si më poshtë vijon:

19.1 Për mjekët:

a) për çdo shërbim rojë, 24 orë pa ndërprerje, masa e shtesës përcaktohet sipas institucioneve, si më poshtë vijon:

Në qendrat spitalore universitare	Mjek rojë i parë	Mjek rojë i dytë
për ditët e zakonshme	6 000 lekë	5 600 lekë
për ditët e shtuna	7 000 lekë	6 400 lekë
për ditët e diela e festat	8 000 lekë	7 600 lekë
Në institucionet e tjera	Mjek rojë i parë	Mjek rojë i dytë
për ditët e zakonshme	5 600 lekë	5 200 lekë
për ditët e shtuna	6 000 lekë	5 600 lekë
për ditët e diela dhe festat	7 000 lekë	6 600 lekë

b) për shërbimin e urgjencës së spitalit, që është organizuar dhe funksionon si i tillë, si dhe për shërbimin e urgjencës në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor, që ofrojnë shërbim të pandërprerë për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës, masa e shtesës përcaktohet, si më poshtë vijon:

	Në ditët e zakonshme	Në ditët e shtuna	Në ditët e diela dhe të festave zyrtare
për sistemin 24 orë	2 300 lekë	2 400 lekë	2 700 lekë
për sistemin 16 orë	2 000 lekë	2 300 lekë	2 400 lekë
për sistemin 12 orë	1 800 lekë	2 000 lekë	2 300 lekë

c) për raste të tjera të veçanta, kur mjeku i rojës e shih të domosdoshme thirrjen e mjekëve për veprime diagnostikuese apo mjekuese, masa e shtesës për vlerën orare të punës për çdo rast dhe numri i orëve shtesë është sipas përcaktimeve në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.

19.2 Për punonjësit e personelit teknik të shkencave mjekësore:

a) për shërbimin e urgjencës së spitalit, si dhe për shërbimin e urgjencës në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor, që ofrojnë shërbim të pandërprerë për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës, u jepet një shtesë, në masën:

	Në ditët e zakonshme	Në ditët e shtuna	Në ditët e diela dhe të festave zyrtare
për sistemin 24 orë	1 700 lekë	2 100 lekë	2 500 lekë
për sistemin 16 orë	1 400 lekë	1 700 lekë	2 200 lekë
për sistemin 12 orë	1 100 lekë	1 400 lekë	1 700 lekë

b) për rastet kur, me kërkesë të institucionit dhe miratim të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë e të ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen, punonjësve “teknik laborator” të spitaleve që kryejnë shërbim 24-orë, u jepet një shtesë mbi pagë, si më poshtë vijon:

për ditë të zakonshme	1 700 lekë
për ditët e shtuna	2 100 lekë
për ditët e diela dhe festa	2 500 lekë

c) Për raste të tjera të veçanta, kur mjeku i rojës e sheh të domosdoshme thirrjen e personelit “teknik të shkencave mjekësore” për të ndihmuar në procesin e kryerjes së diagnostikimit apo të mjekimit, masa e shtesës për vlerën orare të punës për çdo rast dhe numri i orëve shtesë është sipas përcaktimeve në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.

19.3 Për shoferët e autoambulancave në ato qendra shëndetësore të kujdesit parësor, që ofrojnë shërbim të pandërprerë, në rastet kur kryejnë shërbim 24 orë, u jepet një shtesë, si më poshtë vijon:

	Në ditët e zakonshme	Në ditët e shtuna	Në ditët e diela dhe të festave zyrtare
për sistemin 24 orë	1 500 lekë	1 700 lekë	1 900 lekë
për sistemin 16 orë	1 300 lekë	1 500 lekë	1 700 lekë
për sistemin 12 orë	1 100 lekë	1 300 lekë	1 500 lekë

20. Mjekët, që janë efektivë me kohë të plotë në korpusin akademik të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, të cilët njëkohësisht shërbejnë në institucione të ndryshme shëndetësore, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave përfitojnë një trajtim financiar, si më poshtë vijon:

a) kur shërbejnë në strukturat shëndetësore universitare dhe në Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave, në pozicionin “shef shërbimi”, masa e trajtimit financiar, sipas nivelit të kualifikimit shkencor përkatës, është:

1.	Grada shkencore/titulli akademik	Masa e trajtimit financiar (lekë në muaj)
1	Shef shërbimi me titullin “Profesor”	125 000
2	Shef shërbimi me titullin “Profesor i asociuar”	120 000
3	Shef shërbimi me gradën shkencore “Doktor”	117 000

b) kur shërbejnë në Institutin e Shëndetit Publik, në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe në Klinikën Stomatologjike Universitare, si dhe zotërojnë gradën shkencore “Doktor” apo titujt akademik “Profesor” dhe/ose “Profesor i asociuar”, për shërbimin që ofrojnë pranë këtyre strukturave, masa e trajtimit financiar të tyre është në vlerën 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë në muaj.

21. Mjekët e sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, të cilët, pas përfundimit të specializimit në spitalet universitare, në bazë të detyrimit kontraktual me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, emërohen sipas nevojave të sistemit shëndetësor, larg vendbanimit të tyre, për një periudhë 3-vjeçare, përfitojnë një kompensim për kosto jetese, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, sipas specifikimeve që miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, bazuar në shtrirjen territoriale të shërbimit spitalor. Këta punonjës nuk përfitojnë kompensimin për largësi nga vendbanimi, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

22. Punonjësit e personelit “teknik të shkencave mjekësore”, të cilët punojnë në institucionet shëndetësore, larg vendbanimit të tyre, marrin një kompensim mujor, në masën, si më poshtë vijon:

22.1 Në qendrat shëndetësore të shërbimit parësor:

a) kur largësia, nga vendbanimi deri në qendrën shëndetësore është në distancën 5 km deri në 10 km, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj;

b) kur largësia, nga vendbanimi deri në qendrën shëndetësore është në distancën mbi 10 km në 20 km, në masën 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë në muaj;

c) kur largësia, nga vendbanimi deri në qendrën shëndetësore është në distancën mbi 20 km, në masën 3 000 (tre mijë) lekë në muaj;

22.2 Në institucionet shëndetësore me shtretër:

a) kur largësia, nga vendbanimi deri në spital është në distancën mbi 10 km në 20 km, në masën 1 500 (njëmijë e pesëqind) lekë në muaj;

b) kur largësia, nga vendbanimi deri në spital është në distancën mbi 20 km, në masën 3 000 (tre mijë) lekë në muaj;

kur këta punonjës nuk kthehen në vendbanimin e tyre brenda ditës, 4 000 (katër mijë) lekë në muaj.

23. Titullarët e institucioneve, në varësi të ministrit për çështjet e shëndetësisë, me qëllim realizimin me efektivitet dhe eficiencë të misionit dhe objektivave të institucionit që drejojnë, kanë të drejtë që për të marrë këshillimin e duhur për çështje specifike të kenë këshilltarë të jashtëm. Kontraktimi i këshilltarëve të jashtëm bëhet pas miratimit të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Paga e këshilltarëve të jashtëm bëhet nga llogaria ekonomike, e përcaktuar sipas udhëzimit përkatës të zbatimit të buxhetit të ministrit përgjegjës për financat dhe përcaktohet nga titullari përkatës, në masën deri në 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë në muaj.

24. Trajnimi i personelit mjekësor, personelit paramedikal dhe publikut të gjerë kryhet nëpërmjet veprimtarive të trajnimit që organizohen nga vetë Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore ose/dhe në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë apo qendrat spitalore. Në rastet kur punonjësit e personelit mjekësor (me arsim të lartë) të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore marrin pjesë në veprimtaritë e trajnimit (si për personelin mjekësor ashtu edhe për personelin paramedikal dhe publikun e gjerë), të cilat organizohen nga vetë qendra, për çdo orë mësimi 60-minutëshe, përfitojnë trajtim me pagesë, si më poshtë vijon:

a) trajnerët me më pak se 10 (dhjetë) vite pune në profesion përfitojnë një pagesë, në masën 1 000 (një mijë) lekë për orë;

b) trajnerët me më shumë se 10 (dhjetë) vite pune në profesion përfitojnë një pagesë, në masën 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë për orë;

c) trajnerët, të cilët janë punonjës efektivë të personelit “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë”, të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, e përfitojnë këtë pagesë deri në 200 (dyqind) orë në vit, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë;

ç) në rastet kur trajnerët janë bashkëpunëtorë të jashtëm nga Universiteti i Mjekësisë apo nga qendrat spitalore, pagesa për orë/trajnimi do të jetë e njëjtë me trajnerët e brendshëm të qendrës.

25. Trajtimi financiar për punonjësit e palës turke të personelit të administrimit të përgjithshëm, të personelit mjekësor dhe të personelit teknik të shkencave mjekësore:

a) për një periudhë transitorë, në bazë të marrëveshjes dypalëshe, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, si dhe të vendimit nr. 58, datë 26.1.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e protokollit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, gjatë fazës kalimtare”, pagat mujore bruto të punonjësve të palës turke:

i. të personelit të administrimit të përgjithshëm;

ii. të personelit mjekësor;

iii. të personelit teknik të shkencave mjekësore,

janë të njëjta me pagat mujore bruto të çdo pozicioni respektiv pune të personelit të palës shqiptare në institucionet shëndetësore me shtretër.

b) përveç pagës mujore bruto, të përcaktuar si më sipër, punonjësit e palës turke:

i. të personelit të administrimit të përgjithshëm;

ii. të personelit mjekësor;

iii. të personelit teknik të shkencave mjekësore,

përfitojnë një shpërblim mujor, në masën e përcaktuar në lidhjen nr. 11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

26. Për një periudhë transitorë, mjekët e qendrave shëndetësore të shërbimit të kujdesit parësor, të cilët ushtrojnë mjekësinë familjare, të cilët do të rezultojnë me pagë bruto mujore aktuale më të lartë nga sa përcaktohet në këtë vendim, do të trajtohen me pagë në ruajtje, si më poshtë vijon:

a) Në rastet e mbulimit aktual për banorë, pa përfshirë mbulimin për banorë të një mjeku tjetër, për shkak të mungesës së tij të përkohshme në punë për një periudhë të zgjatur, për mjekët që rezultojnë me pagë bruto mujore aktuale, më të lartë nga sa përcaktohet në këtë vendim, paga në ruajtje do të llogaritet si diferencë midis pagës bruto që përfitonin këta mjekë, përpara miratimit të këtij vendimi me pagën bruto mujore, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;

b) Në rastet e mbulimit aktual për banorë, përfshirë edhe mbulimin për banorët e një zone të pambuluar me mjekë, për shkak të vendeve vakante, si dhe në zbatim të udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për çështjet e shëndetësisë, për mbulimin e çdo zone me mjekë, për mjekët që rezultojnë me pagë bruto mujore më të lartë nga sa përcaktohet në këtë vendim, paga në ruajtje do të llogaritet si diferencë midis pagës bruto që përfitonin këta mjekë përpara miratimit të këtij vendimi me pagën bruto mujore, sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Këta mjekë do të trajtohen me pagën në ruajtje, deri në plotësimin e vendit vakant.

27. Mjekët që do të punësohen për herë të parë në qendrat shëndetësore të shërbimit të kujdesit parësor, të cilët, në zbatim të udhëzimit përkatës të ministrit përgjegjës për çështjet e shëndetësisë për mbulimin e çdo zone me mjekë, do të ushtrojnë mjekësinë familjare, do të trajtohen me pagë, sipas përcaktimeve të lidhjeve përkatëse të këtij vendimi, dhe, në asnjë rast, nuk përfitojnë pagë në ruajtje, sipas përcaktimeve të pikës 26, të këtij vendimi.

28. Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve, që bëjnë pjesë në fushën e veprimit të këtij vendimi, përcaktohen në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve të administratës publike.

29. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, përballohen nga fondet buxhetore, të miratuara për vitin 2024, si dhe nga fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për Ministrinë e Mbrojtjes, për Ministrinë e Drejtësisë, për Ministrinë e Brendshme dhe për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

30. Vendimi nr. 555, datë 11.8.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

31. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2024.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Vlerat e elementeve “pagë për pozicion” për punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga “specialist” deri në “titullar institucioni” në institucionet e shërbimeve shëndetësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, të përcaktuara në nënpikën 3.1, të pikës 3, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimi	Grupi i diplomës	Paga për pozicion (lekë/muaj)
1	Titullar institucioni në QSU “Nënë Tereza”.	1	205,000
2	Titullar institucioni në:	1	180,000

	- Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”. - Spitalin rajonal “Memorial” Fier. - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë.		
3	Titullar institucioni në: - Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr. 1 dhe nr. 2 Tiranë. Zëvendësstitullar institucioni: - në QSU “Nënë Tereza”.	1	170,000
4	Titullar institucioni në: - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë. - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Zëvendësstitullar institucioni në: - Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”. - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë. - Spitalin rajonal “Memorial” Fier.	1	160,000
5	Titullar institucioni në qendrat spitalore rajonale.	1	155,000
6	Titullar institucioni në: - Spitalet rajonale. - Spitalet psikiatrike. - Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale (profili mjekësor /ekonomik). Konsulent mjekësor në spitalet universitare dhe terciare. Zëvendësstitullar institucioni në: - Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr. 1, nr. 2 Tiranë. - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë. - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	141,000
7	Titullar institucioni në spitalet bashkiake.	1	138,000
8	Titullar institucioni në spitalet ditore. Zëvendësstitullar institucioni në qendrat spitalore rajonale.	1	130,000
9	Zëvendësstitullar institucioni në spitalet rajonale/psikiatrike. Drejtor drejtorie në QSU “Nënë Tereza”.	1	121,000
10	Zëvendësstitullar në spitalet bashkiake/ditore. Drejtor drejtorie në: - Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”. - Spitalin Rajonal “Memorial” Fier. - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë.	1	115,000
11	Drejtor drejtorie në Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr. 1, nr. 2 Tiranë. Administrator për Polin e Administrimit të Integruar në QSU “Nënë Tereza”.	1	105,000
12	Përgjegjës sektori biomedikal në spitalet universitare.	1	100,000
13	Drejtor drejtorie në qendrat spitalore rajonale. Përgjegjës sektori në : - spitalet universitare. - Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”. - në spitalin rajonal “Memorial” Fier.	1	95,000
14	Përgjegjës sektori në : - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. - Klinikën Stomatologjike Universitare.	1	90,000
15	Përgjegjës Sektori në qendrat spitalore rajonale.	1	85,000
16	Specialist në: QSU “Nënë Tereza”; Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, Spitalin Rajonal “Memorial” Fier.	1 ose 2 ose 3	85,000
17	Përgjegjës sektori në spitalet rajonale dhe psikiatrike.	1	80,000
18	Specialist në: - në Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr. 1, nr. 2 Tiranë. - Spitalin Universitar të Traumës Tiranë - Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë. - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1 ose 2, ose 3	80,000
19	Përgjegjës sektori në spitalet bashkiake/ditore.	1	70,000

20	Specialist në: - qendrat spitalore rajonale - spitalet rajonale dhe psikiatrike.	1 ose 2, ose 3	70,000
21	Specialist në spitalet bashkiake/ditore.	1 ose 2, ose 3	60,000

Lidhja nr. 2

Vlerat e elementit “pagë për pozicion” për personelin “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe “teknikë të shkencave mjekësore”, në institucionet e ofrimit të shërbimit shëndetësor, të përcaktuara në nën pikën 3.1, të pikës 3, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimi	Grupi i diplomës	Paga për pozicion (lekë/muaj)
Kreu I	Në spitalet universitare/terciare, në shërbimin universitar /terciar në Qendrën Spitalore Rajonale Tiranë “Shefqet Ndroqi” dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës		
	Për personelin “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë”		
1	Drejtuues mjekësor në QSU “Nënë Tereza”. Shef shërbimi.	1	160,000
2	Përgjegjës njësie/klinike/kabineti (mjek me specialitet) në shërbimin spitalor universitar/terciar.	1	146,000
3	Përgjegjës mjekësor në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (mjek me specialitet).	1	141,000
4	Mjekë me specialitet në: - shërbimin spitalor universitar/terciar. - Klinikën Stomatologjike Universitare. - Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1	135,000
5	Shef/përgjegjës farmacie. Përgjegjës në sektorin e infeksioneve spitalore (mjek).	1	119,000
6	Mjek i përgjithshëm/Stomatolog në shërbimet klinike. Fizikant/ Biolog/ Kimist në: - në shërbimin spitalor universitar/terciar. - në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Farmacist. Specialist i shëndetit publik (mjek në sektorin e infeksioneve spitalore).	1	113,000
7	Specialist i shëndetit publik (në sektorin e infeksioneve spitalore).	1 ose 2	96,000
8	Psikolog/punonjës social/specialist fizkulture.	1 ose 2	94,000
	Për personelin “teknik të shkencave mjekësore”		
1	Kryeinfermier i përgjithshëm. Kryemami i përgjithshëm.	1 ose 2 ose 3	85,000
2	Kryeinfermier shërbimi/njësie/klinike, në shërbimin infektiv në QSU “Nënë Tereza”. Kryeinfermier shërbimi/Klinike/Njësi Psikiatrike. Kryeinfermier shërbimi në Terapi Intensive/Onkologjik/Neurokirurgji. Kryelaborant në Histopatologji/Anatomi Patologjike. Kryeinfermier/Kryelaborant në Radioterapi/Imazheri dhe Mjekësi Nukleare. Kryeinfermier/kryemami njësie/klinike i Terapisë Intensive/ Strokë dhe Poststrokë. Kryeinfermier në Hemodinamikë/Kemioterapi.	1 ose 2 ose 3	82,000
3	Kryeinfermier shërbimi. Kryemami shërbimi. Kryelaborant shërbimi.	1 ose 2 ose 3	80,400
4	Infermier në Hemodinamikë.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	80,400
5	Infermier/laborant në psikiatri. Laborant histopatolog. Infermier/mami në Reanimacion/Neonatologji.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	77,500

	Infermier në Kimioterapi/dhomën e zgjimit.		
6	Kryeinfermier njësie/klinike pranim në urgjencë. Kryeinfermier/ kryemami / kryelaborant.	1 ose 2 ose 3	70,100
7	Laborant radiolog në Onkologji. Laborant në Radioterapi/në Mjekësinë Nukleare. Laborant klinik biokimik. Laborant radiolog. Laborant në neurofiziologji. Infermier në Punktin e gjakut/ Hematologji/ Hemodializë/ Onkologji/Endoskopi/Toksikologji. Infermier/laborant bakteriolog /imunolog. Infermier njësie/klinike Radiologji/Angio CT. Teknik imazherie dhe Angio CT. Infermier në Kirurgji/Maksilofaciale/Neurokirurgji/ Kardiokirurgji/Djegje plastike. Infermier/mami në Obsetrikë/ Gjinekologji/Patologji barre/ Neonatologji. Infermier salle. Infermier/laborant në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	70,100
8	Infermier në njësinë e radioterapisë dhe mjekësisë nukleare/ në litotripsi. Infermier në Shërbimin Infektiv në QSU “Nënë Tereza”. Infermier pranim urgjence (njësia e koordinimit të urgjencës). Infermier në fizioterapi. Laborant/infermier/mami/logoped. Prozektor.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	69,000
9	Kujdestar. Oksigjenist.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	60,000
Kreu II	Në shërbimet e tjera në qendrën spitalore rajonale Tiranë “Shefqet Ndroqi”, në qendrat spitalore rajonale, në spitalet rajonale/psikiatrike/bashkiake/ditore		
	Për personelin “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë”		
1	Zëvendësdyrëtor mjekësor/ shef shërbimi (mjek me specialitet).	1	137,000
2	Përgjegjës njësie/klinike/ Kabineti/Poliklinike/Laboratori, (mjek me specialitet). Përgjegjës i Bankës së Gjakut.	1	124,000
3	Mjek me specialitet.	1	119,000
4	Përgjegjës/Shef farmacie.	1	113,000
5	Shef/përgjegjës njësie/klinike (mjek i përgjithshëm).	1	100,000
6	Mjek i përgjithshëm. Stomatolog. Farmacist. Kimist/fizikan/biolog.	1	96,000
7	Specialist i shëndetit publik (në sektorin e infeksioneve spitalore).	1 ose 2 ose 3	85,000
8	Psikolog, Punonjës social.	1 ose 2 ose 3	80,000
	Për personelin “teknik të shkencave mjekësore”		
1	Kryeinfermier i përgjithshëm. Kryeinfermier njësie/klinike në spitalet psikiatrike.	1 ose 2 ose 3	80,100
2	Kryeinfermier. Kryelaborant.	1 ose 2 ose 3	77,000
3	Laborant në Anatominë Patologjike.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	75,000
4	Kryeinfermier në poliklinikën e spitalit.	1 ose 2 ose 3	69,000
5	Infermier/ laborant në Psikiatri. Infermier. Laborant. Fizioterapist. Logopedist. Përgjegjës turni. Ndihmësanestezist. Ndihmësfarmacist. Prozektor.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	69,000
6	Kujdestar. Ndihmësinfermier. Oksigjenist.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	60,000

Vlerat e elementeve “pagë për pozicion” për punonjësit e administrimit të përgjithshëm nga “specialist” deri në “titullar institucioni”, në institucionet shëndetësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë të përcaktuara në nënpikat 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimet e pozicioneve të punës	Grupi i diplomës	Paga për pozicion (lekë/muaj)
1	Titullar institucioni në: - Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.	1	180,000
2	Titullar institucioni në: - Qendrën Kombëtare të Trajtimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve. - Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore.	1	170,000
3	Titullar institucioni në Qendrën e Shërbimeve Mjekësore. Zëvendëstitullar institucioni në: - Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor. - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore. - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.	1	155,000
4	Zëvendëstitullar institucioni në: - Qendrën Kombëtare të Trajtimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve. - Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore.	1	141,000
5	Titullar institucioni në drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.	1	135,000
6	Titullar institucioni në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në qarqe.	1	130,000
7	Drejtor në drejtoritë e përmbajtjes në: - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore. - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.	1	128,000
8	Titullar institucioni në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në bashki. Drejtor drejtorie në Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.	1	125,000
9	Drejtor në drejtoritë e përmbajtjes në Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore. Drejtor në drejtorinë mbështetëse në: - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore. - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.	1	115,000
10	Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor. Përgjegjës i sektorëve të përmbajtjes në: - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore. - Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore. Përgjegjës sektori në Drejtorinë Qendrore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.	1	100,000
11	Përgjegjës i sektorëve mbështetës në: - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. - Qendrën Kombëtare të Trajtimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve. Përgjegjës sektori në: - Drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor. - Njësitë vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në qarqe.	1	90,000
12	Përgjegjës sektori në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor me qendër në bashki. Specialist (inxhinier/IT/biomedikal) në Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore	1	85,000
13	Përgjegjës i sektorëve mbështetës në: - Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore.	1	80,000

	- Qendrën e Shërbimeve Mjekësore.		
14	Specialist promocioni në Qendrën Kombëtare të Trajtimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve. Specialist, (niveli i parë) në Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.	1 ose 2 ose 3	80,000
15	Specialist finance (nëpunës zbatues) në qendrat shëndetësore të specialiteteve /qendrat shëndetësore.	1	70,000
16	Specialist në: - Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore; - Qendrën Kombëtare të Trajtimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve; - Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; - Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore; - Qendrën e Shërbimeve Mjekësore; - Specialist, niveli i dytë në Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.	1 ose 2 ose 3	70,000
17	Specialist në: - njësitë vendore të kujdesit shëndetësor; - qendrat shëndetësore të specialiteteve/qendrat shëndetësore.	1 ose 2 ose 3	65,000

Lidhja nr. 4

Vlerat e elementit “pagë për pozicion”, për personelin “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe “teknikë të shkencave mjekësore”, në institucionet shëndetësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, të përcaktuara në nënplikat 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimi	Grupi i diplomës	Paga për pozicion (lekë/muaj)
Kreu I	Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët		
1	Shef shërbimi (mjek me specialitet)	1	137,000
2	Mjek me specialitet	1	121,000
3	Mjek i përgjithshëm në shërbimin klinik	1	96,000
4	Specialist psikolog, punonjës social/pedagogji e specializuar	1 ose 2 ose 3	90,000
5	Terapist/fizioterapist/logopedist	1 ose 2 ose 3	89,000
6	Kryeinfermier	1 ose 2 ose 3	76,000
7	Infermier	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	67,000
8	Kujdestar	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	60,000
Kreu II	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore		
1	Përgjegjës/Shef sektori në sektorët e përmbytjes për kontrollin e barnave dhe pajisjeve mjekësore.	1	113,000
2	Farmacist. Analist. Mjek. Inxhinier për pajisjet mjekësore. Inspektor për Kontrollin Farmaceutik	1	105,500
3	Laborant	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	77,000
Kreu III	Qendra e Shërbimeve Mjekësore		
1	Mjek me specialitet	1	119,000
2	Mjek i përgjithshëm. Stomatolog	1	96,000
3	Kryeinfermier	1 ose 2 ose 3	79,000
4	Infermier. Ndihmës stomatolog	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	67,000
Kreu IV	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore		
1	Specialist (mjek i përgjithshëm)	1	115,000
2	Kryeinfermier urgjence	1 ose 2 ose 3	81,000
3	Infermier urgjence	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	78,000
Kreu V	Njësitë vendore të kujdesit shëndetësor		

1	Shef shërbimi (mjek me specialitet) që punojnë në shërbimet e shëndetit publik. Përgjegjës në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër dhe shërbimet komunitare (mjek psikiatër).	1	127,000
2	Shef shërbimi (mjek).	1	125,500
3	Mjek me specialitet që punojnë në shërbimet e shëndetit publik. Mjek psikiatër në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor. Mjek psikiatër që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër dhe shërbimet komunitare.	1	119,000
4	Përgjegjës/shef në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër dhe shërbimet komunitare (punonjës social psikolog).	1	105,000
5	Mjek. Stomatolog.	1	96,000
6	Psikolog/punonjës social që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor.	1	82,000
7	Specialist në shërbimet e shëndetit publik. Specialist në sektorin e shërbimit parësor.	1 ose 2 ose 3	77,000
8	Kryeinfermier/kryevaksinator.	1	76,000
9	Teknik specialitetesh shëndetësore. Infermier/terapist në shërbimet e shëndetit mendor. Infermier.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	69,500
Kreu VI	Instituti i Shëndetit Publik		
1	Mjek me specialitet.	1	119,000
2	Laborant kimist, mikrobiolog, biokimist në njësinë e shëndetit dhe mjedisit dhe të vivariumit.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	68,500
3	Laborant mikrobiologji teknike laborator/ infermier në njësinë e epidemiologjisë dhe sëmundjeve infektive. Teknik imazherie.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	66,500
Kreu VII	Qendrat shëndetësore të kujdesit parësor		
1	Mjek të specializuar që punojnë në specialitete dhe në mjekësi familjare	1	124,000
2	Mjete të përgjithshëm që punojnë në mjekësi familjare	1	110,000
3	Mjek i përgjithshëm që punon në specialitete	1	95,000
4	Kimist	1 ose 2 ose 3	75,000
5	Psikolog/punonjës social	1 ose 2 ose 3	72,000
6	Kryeinfermier/kryemami	1 ose 2 ose 3	69,000
7	Laborant bakterologjik / klinik biokimik, logoped. Infermiere (hematologji, onkologji). Laborant rëntgeni. Infermier ortopedi. Infermier/laborant në fizioterapi. Orthopist. Infermiere në kirurgjinë vazale	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	69,000
8	Infermier/mami. Ndihmës bakterolog	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	64,000
9	Ndihmës infermier	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	58,000

Lidhja nr. 5

Vlerat e elementit “shtesë për kushte pune” për punonjësit e personelit “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” në institucionet e përcaktuara në nën pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimi	Shtesa për kushte pune (lekë/ muaj)
Kreu I	Në spitalet universitare/terciare, në shërbimin universitar /terciar në Qendrën Spitalore Rajonale Tiranë “Shefqet Ndroqi” dhe në Njësinë Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës	
1	Shef shërbimi infektiv në QSU “Nënë Tereza”. Përgjegjës njësie/klinike në Shërbimin Infektiv (mjek me specialitet). Përgjegjës njësie/klinike në Psikiatri/Radioterapi/Mjekësi nukleare (mjek me specialitet). Mjek me specialitet në shërbimin infektiv në QSU “Nënë Tereza”.	8,000

	Mjek me specialitet në shërbimet psikiatrike. Psikolog/Punonjës social, specialist fizikulture në shërbimet psikiatrike.	
2	Përgjegjës njësie/klinike në Reanimacion /Kemioterapi. Përgjegjës Laboratori. Përgjegjës i Qendrës së Diagnozës Molekulare (mjek me specialitet). Mjekë me specialitet në shërbimet e Reanimacionit/Mjekësi Nukleare/ Radiologji/Radioterapi/Neonatologji/Hemodinamikë/ Urgjencë. Fizikan në shërbimet Mjekësi Nukleare/ Radiologji/Radioterapi.	5,000
3	Mjekë me specialitet në shërbimet Kirurgji/ Onkologji/ Obsetrikë-Gjinekologji/ Fizioterapi/ Pneumofiziatri/ Toksikologji/Kemioterapi/ Laborator/ Hematologji/Pneumologji. Mjek me specialitet në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.	3,000
Kreu II	Në shërbimet e tjera në Qendrën Spitalore Rajonale Tiranë “Shefqet Ndroqi”, në qendrat spitalore rajonale, në spitalet rajonale/psikiatrike/bashkiake/ditore	
1	Shef Shërbimi Psikiatri. (mjek me specialitet). Përgjegjës njësie/klinike psikiatrie (mjek me specialitet). Mjek psikiatër/Mjek specialist në spitalet psikiatrike. Mjek i përgjithshëm/ Stomatolog / Farmacist/ Psikolog/Punonjës social në spitalet psikiatrike.	8,000
2	Mjekë me specialitet në shërbimet e Reanimacionit/Radiologji/ Neonatologji/ Hemodinamikë/ Urgjencë.	5,000
3	Shef Shërbimi në Infektiv (mjek me specialitet). Përgjegjës i Bankës së Gjakut/Njësia së Imazherisë/ Pneumoftiziatri/ Laboratori (mjekë me specialitete). Mjekë me specialitet në shërbimet Kirurgji/ Infektiv/Onkologji/ Obsetrikë-Gjinekologji/ Fizioterapi/ Transfuziologji/ Pneumofiziatri /Toksikologji/ Kemioterapi/ Laborator/ Hematologji	3,000
Kreu III	Në institucionet shëndetësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë të përcaktuara në nënparagraf 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi	
	Në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	
	Përgjegjës/Shef sektori në sektorët për kontrollin e barnave. Farmacist. Analist. Mjek. Inxhinier për pajisjet mjekësore. Inspektor për Kontrollin Farmaceutik.	5,000
	Në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët	
	Shef shërbimi (mjek me specialitet)/Mjek me specialitet/Mjek në shërbimin klinik/Specialist psikolog /Punonjës social/Pedagogji e specializuar.	5,000
	Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor	
	Mjek/specialist në shërbimet e shëndetit publik.	7,000
	Përgjegjës/shef në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër dhe shërbimet komunitare. Mjek psikiatër që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër dhe shërbimet komunitare. Psikolog/punonjës social që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor.	5,000
	Në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor	
	Mjek në: Fizioterapi, Kirurgji, Ortopedi, Pneumologji, ORL, Sëmundje Infektive, Gastrohepatologji, Neurologji, Dermatologji, Psikiatri, Kardiologji, Alergologji, Nefrologji, Endokrinologji, Reumatologji, Okulistikë, Patologji, Urologji, Sëmundje profesionale, Hematologji, Onkologji, Mikrobiologji, Laborator, Obstetrikë-Gjinekologji, Pediatri, Radiologji. Kimist.	5,000

Lidhja nr. 6

Vlerat e elementit “shtesë për kushte pune” për punonjësit e personelit “teknikë të shkencave mjekësore”, në institucionet e përcaktuara në nënparagraf 3.1, 3.2 dhe 3.3 , të pikës 3, të këtij vendimi

Nr.	Emërtimi	Shtesa për kushte pune (lekë/muaj)
Kreu I	Në spitalet universitare/terciare, në shërbimin universitar /terciar në Qendrën Spitalore Rajonale Tiranë “Shefqet Ndroqi” dhe në Njësia Mjekësore Ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës	
1	Kryeinfermier i përgjithshëm. Kryemami i përgjithshëm.	8,000

	Kryeinfermier shërbimi/njësie/klinike në Shërbimin Infektiv në QSU “Nënë Tereza”. Infermier në shërbimin infektiv në QSU “Nënë Tereza”. Kryeinfermier shërbimi psikiatrik. Kryeinfermier klinike/Njësi Psikiatrike. Infermier/laborant/kujdestar në Psikiatri.	
2	Infermier në njësinë e radioterapisë dhe mjekësisë nukleare. Infermier në litotripsi. Laborant radiolog në Onkologji. Laborant në Radioterapi. Laborant në Mjekësinë Nukleare. Laborant histopatolog. Infermier në dhomën e zgjimit. Infermier/mami në shërbimet e Reanimacionit/Neonatologji.	3,000
Kreu II	Në spitalet rajonale/psikiatrike/bashkiake/ditore, në qendrat spitalore rajonale dhe personeli civil, teknik i shkencave mjekësore, në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të sistemit të ministrisë së Mbrojtjes	
1	Kryeinfermier i përgjithshëm në spitalet psikiatrike. Kryeinfermier njësie/klinike në spitalet psikiatrike. Infermier/laborant/kujdestar në Psikiatri.	8,000
2	Laborant në Anatominë Patologjike.	5,000
Kreu III	Në institucionet shëndetësore të sistemit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë të përcaktuara në nënplik 3.2 dhe 3.3, të pikës 3, të këtij vendimi	
	Në Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët	
	Terapist /fizioterapist/logopedist. Kryeinfermier. Infermier. Kujdestar.	5,000
	Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor	
	Infermier/terapist në shërbimet e shëndetit mendor.	5,000
	Në Institutin e Shëndetit Publik	
	Laborant mikrobiologji teknike laboratorit/infermier në njësinë e epidemiologjisë dhe sëmundjeve infektive. Teknik imazherie.	8,000
	Laborant kimist, mikrobiolog, biokimist në njësinë e shëndetit dhe mjedisit dhe të vivariumit.	3,700
	Në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor	
	Infermier hematologji/onkologji/laborant rëntgeni	3,000
	Infermier ortopedi. Infermier/laborant në Fizioterapi. Orthopist. Infermier në kirurgjinë vazale.	2,500

Lidhja nr. 7

Vlerat e elementeve “pagë për pozicion” dhe “shtesë për kushte pune” për punonjësit e personelit “mjekë dhe punonjës të tjerë me arsim të lartë” dhe “teknikë të shkencave mjekësore”, në institucionet e tjera të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, të përcaktuara në nënplik 3.5, të pikës 3, të këtij vendimi.

Nr.	Emërtimi	Grupi i diplomës	Paga për pozicion (lekë/muaj)	Shtesa për kushte pune (lekë/muaj)
Kreu I	Në Qendrën spitalore të burgjeve dhe në shërbimin shëndetësor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve			
1	Shef shërbimi	1	137,000	5,000
2	Mjek të specialiteteve të ndryshme	1	119,000	4,000
3	Mjek të përgjithshëm. Stomatolog. Farmacist.	1	96,000	4,000
4	Kryeinfermier	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	76,000	5,000
5	Infermier	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	67,000	5,000
Kreu II	Në Njësinë e Helikopterëve të Transportit Mjekësor të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë në strukturat e ministrisë së Mbrojtjes			
1	Kryepilot	1	105,000	10,000
2	Pilot	1	100,000	10,000

3	Teknik Helikopteri fluturues	1	90,000	
4	Teknik i përgjithshëm. Teknik elektrik.	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	60,000	
Kreu III	Për punonjësit civilë të personelit mjekësor dhe të personelit teknik të shkencave mjekësore, në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të sistemit të ministrisë së Mbrojtjes			
1	Mjek të specialiteteve të tjera	1	119,000	
2	Mjek i përgjithshëm	1	96,000	
3	Infermier	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	67,000	
Kreu IV	Për punonjësit e personelit mjekësor civilë, në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit			
1	Shef shërbimi	1	137,000	
2	Mjek të specialiteteve të ndryshme	1	119,000	
3	Mjek të përgjithshëm. Stomatolog. Farmacist.	1	96,000	
4	Kryeinfermier	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	76,000	
5	Infermier/laborant	1 ose 2 ose 3 ose 4 ose 5	67,000	

Lidhja nr. 8

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit

Grupi i diplomës		Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lekë/muaj)
Për personelin “mjekë dhe të tjerë me arsim të lartë” dhe për personelin “teknikë të shkencave mjekësore”	1	Niveli 7 i KSHK-së (Master i shkencave. Master i arteve. “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike.”. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14,000
	2	Niveli 7 i KSHK-së (Master profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12,000
	3	Niveli 6 i KSHK-së (“Bachelor”. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	10,000
Vetëm për punonjësit e personelit “teknikë të shkencave mjekësore”	4	“Diplomë e shkollës së mesme”	8,000
	5	“Dëftesë lirim” (arsimi 8/9-vjeçar) dhe kurse infermierie.	6,000

Lidhja nr. 9

Vlerat e elementeve “paga bazë mujore e pozicionit të punës” dhe “shtesë për kushte pune” për mjekë dhe teknikë të shkencave mjekësore, me tituj e grada shkencore, të cilët janë punonjës efektivë me kohë të plotë, në QSUNT, spitalet universitare, Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi”, spitalin “Memorial” Fier, si dhe në Klinikën Stomatologjike Universitare

	Kualifikimi/grada/titulli shkencor	Paga bazë mujore e pozicionit të punës (lekë/muaj)	Shtesë për kushte pune (lekë/muaj)
1	Shef shërbimi me titullin “Profesor”/“Profesor i asociuar”.	159,000	52,400
2	Shef shërbimi me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	137,040	56,060
3	Profesor	155,400	51,700
4	Profesor i asociuar	135,000	55,100
5	Mjek me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	116,040	64,060

6	Teknik i shkencave mjekësore (në njësinë e ortopedisë në SUT) me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	94,000	15,000
---	--	--------	--------

Lidhja nr. 10

Vlerat e elementeve “paga bazë mujore e pozicionit të punës” dhe “shtesë për kushte pune” për mjekët dhe punonjësit e tjerë, me tituj e grada shkencore, të cilët janë punonjës efektivë me kohë të plotë, në Institutin e Shëndetit Publik

Nr.	Pozicioni	Paga bazë mujore e pozicionit të punës	Shtesë për kushte pune (lekë/muaj)
1	Zëvendës titullar institucioni me titujt “Profesor”/ “Profesor i asociuar”	167,520	10,000
2	Zëvendës titullar institucioni me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	159,000	10,000
3	Përgjegjës i Njesisë bazë me titujt “Profesor”/“Profesor i asociuar”	159,000	10,000
4	Përgjegjës i Njesisë bazë me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	137,040	10,000
5	Përgjegjës sektori me titujt “Profesor”/“Profesor i asociuar”	159,000	10,000
6	Përgjegjës sektori me gradën shkencore “Doktor (PHD)”	137,040	10,000
7	Profesor	155,400	10,000
8	Profesor i asociuar	135,000	10,000
9	Doktor (PHD)	116,040	10,000

Lidhja nr. 11

Shpërblimi për punonjësit e personelit të caktuar nga pala turke në Spitalin Rajonal “Memorial” Fier dhe për punonjësit e personelit të palës turke të caktuar në pozicionet “Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale”

Nr.	Emërtimi i pozicionit	Masa mujore e shpërblimit (lekë/muaj)
1	Nëndrejtor (mjekësor)	270,000
2	Nëndrejtor (ekonomik)	227,000
3	Shef shërbimi	282,800
4	Mjekë të specialiteteve të ndryshme	305,600
5	Farmacist	172,000
6	Kryeinfermier i përgjithshëm	233,600
7	Teknikë të shkencave mjekësore/ infermier në hemodinamikë	188,200
8	Përgjegjës sektori	102,000
9	Specialist	110,000
10	Teknik biomedikal	100,000
11	Teknik të profile të ndryshme	110,000
12	Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale (mjekësor)	295,000
13	Menaxher spitalor në spitalet universitare e rajonale (ekonomik)	250,000